


Mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë



Ngritja e një arkitekture të qëndrueshme të sigurisë

Editoriali

Gjashtë muaj më parë pas transferimit të disa kompetencave nga fusha e sigurisë nga UNMIK-u te IPVQ-ët u themelua organi i parë ekzekutiv i sigurisë në kuadër të IPVQ-ve: Ministria e Punëve të Brendshme. Kjo jo vetëm që ka krijuar mundësi të reja për Qeverinë për të faktuar se ajo mund t'i dalë zot kësaj detyre, por njëherësh përbën edhe një sfidë të re për Kuvendin e Kosovës për arsye se, pos tjerash, ia bën të mundur që aktivisht të angazhohet dhe t'i mbikëqyrë përpjekjet e qeverisë për t'i menaxhuar këto kompetenca.

Cilat janë kompetencat në fushën e sigurisë, dhe çfarë roli duhet të ketë Kuvendi lidhur me këto kompetenca? Këto janë çështjet me të cilat ky edicion special i Buletinit Informativ ASI do të përpiqet t'i adresojë.

Me këtë rast vlen të vihet në dukje se Misioni i OSBE-së në Kosovë që nga viti i shkuar është duke e zhvilluar Programin Profesional për Zhvillimin e Mbikëqyrjes Parlamentare të Sigurisë, së toku me fondacionin "Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura" (DCAF) me seli në Gjenevë dhe në bashkëpunim me partnerët e ASI-it. Fazat fillestare të programit (përfshirë njohjen me parlamentet e vendeve fqinje dhe shqyrtimit të mësimave të mësuara nga përvojat e tyre) janë në përfundim e sipër, ndaj Kuvendi tani duhet të vendosë se si dëshiron ta ushtrojë të drejtën e tij të mbikëqyrjes.

Në këtë edicion të veçantë të Buletinit, ne kemi zhvilluar intervista me tre personalitetet më kryesore nga fusha e sigurisë në IPVQ: Kryetarin e Komisionit për Emergjencë dhe Gatishmëri z. Naim Malokun, Ministrin e Punëve të Brendshme z. Fatmir Rexhepin dhe zyrtarin/eprorin më të lartë të SHPK-së Kolonel Sheremet Ahmeti. Me këtë rast, akëcili prej tyre i ka shpalosur pikëpamjet e tyre mbi progresin dhe sfidat me të cilat po ndeshet Kosova në këtë fushë kaq të ndjeshme.

Arkitektura e ardhshme e Kosovës do të përgatitet nga Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme (RSSB-së), projekt ky i përbashkët i UNDP-së dhe IPVQ-ve, i cili pos të tjerash do të merret edhe me analizimin e çështjeve kryesore që ndikojnë në situatën e sigurisë në Kosovë. Meqë RSSB-ja ka të bëjë jo vetëm me qytetarët, por edhe me përfaqësuesit e tyre në Kuvend, ne kemi përfshirë në këtë edicion edhe një prezantim të shkurtër të procesit. Ndërkaq, për t'i kundruar këto çështje nga një perspektivë më e gjerë, kemi kërkuar nga eksperti i OSBE-së për çështje të mbikëqyrjes parlamentare në Sarajevë, që t'na përshkruajë procesin e reformimit të sektorit të sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë.

Mbetem me shpresë se ky edicion special do të kontribuojë për debatin mbi të ardhmen e sektorit të sigurisë në Kosovë, dhe mënyrës se si do ta mbikëqyrin atë përfaqësuesit e zgjedhur të popullit. Duke mbajtur parasysh se resurset në Kosovë janë të pamjaftueshme, tani mbetet që politikanët të mendojnë se çfarë arkitekture të sektorit të sigurisë janë në gjendje të krijojnë.

*Franklin De Vrieze,
Koordinator i Iniciativës për Mbështetje të Kuvendit*

Editoriali	2
"Ne ende nuk kemi komision për mbikëqyrje të mekanizmave të sigurisë në Kosovë"	3
Ministria e Punëve të Mbrendshme do të bashkëpunojë me Kuvendin e Kosovës në krijimin e arkitekturës së qëndrueshme të sigurisë	6
Përshtypjet nga vizita në Parlamentin e Republikës së Sllovenisë	8
Programi Profesional Zhvillimor mbi Kontrollin Parlamentar të Shërbimeve të Sigurisë	9
"SHPK-ja i nënshtrohet Ligjit dhe e zbaton atë"	10
Kontrolli Parlamentar i Sektorit të Sigurisë	12
Duke punuar sipas librit: Policia dhe të Drejtat e Njeriut në Kosovë	14
OOSBE ndihmon zhvillimin e Policisë së Komuniteteve në Kosovë	16
Rishqyrtim i Sektorit të Sigurisë së Mbrendshme në Kosovë	17
Buletin: Shërbimi Policor i Kosovës	18
Kush do të kryejë shërbimin e policisë mbi policinë? Roli i Inspektoratit të Policisë në Kosovë (IPK)	20
Përvojat e Misionit të OSBE-së në Bosnje dhe Herzegovinë (BiH) në zhvillimin e Kontrollit Parlamentar në Sektorin e Sigurisë në BiH	22
Programi për Këshilltarë të Stafit Parlamentar për kontroll të Komisioneve	24
Regional Parliamentary Conference on Security Oversight	25
Zhvillimet e fundit në Kuvend	26



"Ne ende nuk kemi Komision i cili bën mbikëqyrjen e segmenteve të sigurisë në Kosovë"

ASI / Intervista me Naim Malokun

ASI: Çka nënkuptohet me mbikëqyrje parlamentare? A ka institucione të cilat zbatojnë mbikëqyrjen, përse nevojitet mbikëqyrja parlamentare?

Maloku: Për momentin në Kosovë nuk kemi komision ende të formuar që bën mbikëqyrje parlamentare të segmenteve të sigurisë. Siguria ka qenë përgjegjësi e UNMIK-ut deri tani, por këtë vit ka filluar bartja e disa përgjegjësive në institucionet e Kosovës, në qeverinë e Kosovës. Me formimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme po krijohen edhe mekanizma brenda Kuvendit të Kosovës për të mbikëqyrur segmentet e sigurisë në Kosovë. Mbikëqyrja parlamentare e segmenteve të sigurisë është shumë me rëndësi për një vend, për të mos i tejkaluar kompetencat që i kanë të parapara me ligj segmentet e sigurisë së një vendi..

ASI: Ku e shihni ju rolin e Kuvendit në raport me forcat e sigurisë? Deri në cilën masë ato duhet të jenë të kontrolluara nga Kuvendi: vetëm nëpërmjet kontrollit të mjeteve financiare apo duke ndikuar në procesin e përzgjedhjes së personelit?

Maloku: Jo, Kuvendi nuk do të ndërhyjë në zgjedhje të stafit. Mbikëqyrja parlamentare e segmenteve të sigurisë bëhet prej mbikëqyrjes së buxhetit, pra si shpenzohet buxheti në

ato segmente të sigurisë dhe normalisht mbikëqyrren metodat, mjetet dhe format që i zbatojnë organet e sigurisë në kryerjen e detyrave të tyre.

ASI: Përmendet rolin e Kuvendit, ku e shihni rolin e partive politike në fushën e mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë?

Maloku: Partitë politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, në bazë të rregullores së Kuvendit, ato parti politike pra grupe parlamentare i caktojnë deputet në komision parlamentar dhe përmes deputetëve të tyre, komisionit parlamentar e bëjnë mbikëqyrjen e segmenteve të sigurisë.

ASI: A ka harmoni në qëndrimet e tyre?

Maloku: Ne jemi në ndërtim e sipër. Për më tepër, ne ende nuk kemi Komision i cili bën mbikëqyrjen e segmenteve të sigurisë në Kosovë. Jemi në fazën e trajnimit për të marrë këto kompetenca. Kemi bërë një vizitë në Parlamentin Slloven, tani me 5 dhe 6 qershor e kemi një vizitë në Parlamentin Maqedon, pra vizitojmë Ministrinë e Punëve të Brendshme, vizitojmë Komisionin Parlamentar për Mbrojtje dhe Siguri në Maqedoni, Akademinë Policore atje dhe një stacion policor për të parë nga afër si funksionon stacioni policor me shumë etni në Maqedoni. Ngase ne do të



Naim Maloku

kemi raste të tilla në Kosovë

ASI: Sa kohë duhet që të përfundojnë punët rreth krijimit të këtij komisioni?

Maloku: Në muajin korrik përfundojmë me planin e trajnimit të komisionit, pastaj komisioni parlamentar do të bëjë një raport për Kryesinë e Kuvendit dhe Kuvendin për të gjitha që i kemi vizituar

dhe përvojat që kemi marrë. Ne e kemi vizituar edhe Akademinë Policore në Vuçitri, pastaj Inspektoriatin e Policisë. Do të vizitojmë edhe ndonjë stacion policor në Kosovë. Kemi marrë pjesë në harmonizimin e rregullores për policinë, në bazë të së cilës është ndërtuar, apo ka filluar ndërtimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pastaj përvoja nga parlamentet tjera. Në atë

raport ne do ta paraqesim përfundimin e kësaj fazë të trajnimit dhe do të dalim me propozim se si të quhet ky komision. Ta kemi të qartë, ne ende nuk e dijmë se si do të quhej ky komision.

ASI: Cilat qasje do t'i veçonit në teorinë e mbikëqyrjes së forcave të sigurisë nga vendet demokratike dhe ku e shihni Kosovën në këtë prizëm?

Maloku: Ta marrim për shembull Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të Shërbimeve Sekrete në Slloveni. Atë e udhëheq opozita dhe struktura e komisionit parlamentar apo përbërja e komisionit në

Slloveni shumicën e votave e ka opozita, pra kjo është e rregulluar me ligj atje. Në Maqedoni e udhëheq pozita, në Bosne e udhëheq pozita, pra ne do t'i shohim tash përvojat, praktikat, i pamë në Slloveni i morëm të tëra materialet, rregulloren e komisionit, ligjet, strukturat e shërbimeve sekrete, rregulloren e punës së komisionit parlamentar si bëhet kontrolli i shërbimeve sekrete. Ne na pret një punë mjaft e madhe tani, ngase duhet t'i propozojmë Kryesisë dhe Kuvendit zgjidhje për Kosovën. Për momentin Kosova nuk ka shërbime sekrete të cilat janë nën kontrollin

e Qeverisë, apo të Kuvendit apo nën kontrollin legal institucional. Thuhet që janë disa shërbime sekrete që janë nën kontrollin e partive politike. Ne duhet që të definojmë tani një qasje ndaj këtyre këtyre shërbimeve. Gjithashtu, në qoftë se dikush mendon se ne do ndërhyjmë në pranimin e stafit të Ministrisë së Brendshme, gabon. Komisioni Parlamentar nuk e ka atë kompetencë, dhe në asnjë vend në botë nuk ndodh që Parlamenti të ketë ndikim në pranimin e stafit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, apo të segmenteve të sigurisë.

ASI: Shumë shtete përdorin qasje të ndryshme ndaj policisë së uniformuar, policisë kriminale, shërbimeve informative ose organizatave ushtarake. Çka mendoni për rregulloret e veçanta për pjesë të ndryshme të aparatit të sigurisë?

Maloku: Në çdo vend demokratik janë disa forma të kontrollit. Pra në secilin segment të sigurisë, pavarësisht se a bëhet fjalë për polici apo shërbim sekret ekziston kontrolli i brendshëm. Secili segment i sigurisë e ka një mekanizëm të brendshëm të kontrollit, i cili bëhet brenda ministrisë përkatëse. Ndërsa te shërbimi sekret inteligjent shtetëror është rregullorja e brendshme e punës që e përcakton një mekanizëm që e ka vet organi, pra segmenti i sigurisë. Është kontrolli i dytë - pra shkalla e dytë e kontrollit - kontrolli brenda institucionit të cilit i përket ai segment i sigurisë. Policia i përket Ministrisë së Punëve të Brendshme, pra MPB-ja e ka një mekanizëm të kontrollit të

drejtorisë të policisë. Te ne po bëhet agjencion Inspektoriat i Policisë, i cili do të jetë agjencion i pavarur por do të punojë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky agjencion - Inspektoriat i Policisë - është një mekanizëm i dytë i kontrollit, pra Shërbimi Policor i Kosovës do të ketë një kontroll të brendshëm që e rregullon me rregullore të punës të vetë Shërbimit Policor të Kosovës. Masat disiplinore, ato kontrollet e brendshme të policisë që nuk i kemi pasur. Është shkalla e dytë e kontrollit - agjencion i pavarur Inspektoriat i Policisë - që është duke u ndërtuar në Kosovë, që është në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai i sygjeron Ministrin për masat që duhen marrë dhe e kontrollon si agjencion dhe mekanizëm i pavarur, që e kontrollon punën e Shërbimit Policor të Kosovës në zbatimin e detyrave dhe në përmbajtjen ndaj ligjit, që të mos bëhen shkelje ligjore apo tejkalime të kompetencave gjatë kryerjes të detyrës.

ASI: Kjo vlen për policinë, çka ndodh me strukturat tjera?

Maloku: Në qoftë se p.sh. shërbimi sekret inteligjent i Kosovës ndërtohet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, atëherë ky agjencion do të duhej të ketë një mekanizëm, brenda MPB-së e cila do të bëjë kontrollim si shkallë e dytë e kontrollit. Shkalla e tretë e kontrollit është kontrolli parlamentar. Nëpërmes të komisionit parlamentar, shkallë e tretë e kontrollit janë edhe OJQ-të, të cilat e ushtrojnë një kontroll të segmenteve të sigurisë. Ato me anë të reagimeve të ndryshme,



publikimeve, media, psh. i raportojnë rastet ku janë bërë shkelje, ku janë tejkaluara kompetencat, ankesat e qytetarëve, fotografi, marrin intervista, pra është njëfarë forme e kontrollit.

ASI: Cilët faktorë të tjerë parapëlqeni në mbikëqyrjen e forcave të sigurisë? Çka mendoni për rolin e Komunave, mbikëqyrjes së brendshme dhe juridike?

Maloku: Është duke u ndërtuar Sekretariati për Siguri pranë Qeverisë, aty është edhe Zyra për Siguri. Në Sekretarin për Siguri marrin pjesë, përveç Kryeministrit, edhe segmente të tjera si Ministri i Punëve të Brendshme, shefat e shërbimeve sekrete të mekanizmave që do të ndërtohen. Ne e kemi edhe këshillin që vlerëson gjendjen e sigurisë në Kosovë Qeveri të Kosovës. Aty janë PSSP Jessen-Petersen, Komandaniti i KFOR-it, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit, Ministri i Punëve të Brendshme, Komandanti i TMK-së. Në vende tjera është Këshilli Nacional i Sigurisë i cili e luan këtë rol dhe udhëhiqet nga Kryetari i Shtetit. Ne ende nuk i kemi kompetencat në atë segment. Tash e disa muaj funksionon këshilli për vlerësimin e situatës së sigurisë në Kosovë dhe normalisht në bazë të vlerësimit të situatës së sigurisë jep edhe detyra si psh. KFOR-it, UNMIK-ut, Policisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qeverisë etj. Sekretariati i Sigurisë pranë Qeverisë së Kosovës që përmenda më lartë nuk është ngritur ende por zyrat janë, dhe ai do të ishte nën Këshillin Nacional të Sigurisë.

ASI: Ku e shihni balancin në mes të kontrollit dhe efikasitetit? A mendoni që një aparat i sigurisë i mbikëqyruar aq shumë do të mund të punonte në mënyrë efikase?

Maloku: Kontrolli ka për qëllim që të shmang tejkalimin e kompetencave. Secili që ka forcë në dorë dhe nuk e ka kontrollin mbi të, shumë lehtë mund ta keqpërdor forcën. Forcën e ka policia. Është një forcë e armatosur: ka mundësi të arrestojë dikë, të burgos apo edhe vrasë dikë dhe thotë se e ka vlarë në vetë-mbrojtje. Secili segment i shoqërisë që e ka forcën dhe nuk kontrollohet ka mundësi që ta keqpërdor atë forcë, dhe kontrolli ka për qëllim që segmentet që e kanë forcën mos ta keqpërdorin atë forcë

ASI: Cilat duhet të jenë prioritetet e forcave policore dhe çka mund të bëjë kuvendi që forcat e sigurisë të jenë më efikase?

Maloku: Neve na duhen urgjentisht segmente vendore, segment brenda policisë që lufojnë krimin ekonomik, në mënyrë që nga faqet e para të hiqen akuzat për korrupsion, sepse kjo është bërë temë shumë e përfolur edhe nëpër kafene. Edhe njerëzit që fare nuk dijnë për këtë kanë dëgjuar, dhe thonë që ka korrupsion. Do të thotë një segment shumë efikas brenda Ministrisë së Brendshme që duhet të punojë kundër krimit ekonomik, pastaj kundër krimit të organizuar, kundër trafikimit të ndryshëm, parandalimit dhe ndalimit e marrjes së shumë efikas masave, pra kapjen apo shkatërimin e rrjeteve kriminale të mundshme në Kosovë. Neve na duhet një

policie efikase që ka segmentin anti-drogë, segmentin efikas kundër krimit ekonomik, krimin të organizuar. Këto janë tri segmente që në Kosovë duhet të forcohen dhe të ndërtohen segmente efikase brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme.

ASI: Shqyrtimi mbi sektorin e sigurisë së brendshme dhe studimet tjera kanë vënë në pah se sistemi gjyqësor ende duhet përmirësuar për t'iu afruar kualitetit të punës së SHPK-së dhe besueshmërisë nga qytetarët e Kosovës. A mendoni se mbikëqyrja mund të funksionoj më këtë sistem gjyqësor dhe çfarë përmirësime do të dëshironit të shihni?

Maloku: Sistemi gjyqësor është i fundit. Mbikëqyrja e segmenteve të sigurisë është një gjë, ndërsa sistemi gjyqësor është diçka tjetër. Ngase sistemi gjyqësor merret me rastet të cilat i dorëzohen sistemit gjyqësor, pra u dorëzohet rasti dhe ata duhet të bëjnë gjykimin. Deri te gjykimi, dorëzimi i rastit, përgatitja e rastit dhe dorëzimi te prokurori ka shumë punë. E për të qenë efikase një gjyqësi duhet të mos ketë presion mbi gjyqësinë. Gjyqësia duhet të jetë e pavarur, mos t'i nënshtrohet presionit institucional, që te ne në Kosovë nuk besoj që ka për shkak se gjyqësia është ende kompetencë e UNMIK-ut. Mirëpo duhet të punojmë shumë në ndalimin dhe pengimin e presionit jashtë-institucional mbi organet e gjyqësisë. Jam shumë i bindur që në shoqërinë kosovare ekziston presioni jashtë-institucional mbi organet e gjyqësisë, dhe ne duhet marrim masa. Duhet të ngriten

segmentet e sigurisë, shërbimi inteligjent dhe segmentet e sigurisë brenda shërbimit policor të Kosovës, të cilat do t'ia sigurojnë jetën gjyqtarit tonë, ta sigurojnë që ai mos të bjerë pre e presioneve apo kërcënimeve. Sa i përket korrupsionit në gjyqësi, është bërë shumë zhurmë për një gjykatës që i ka marrë një mijë euro dhe rastin tjetër për një qerre dru... Kjo është qesharake kur ka raste shumë më serioze. Policia dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të fitojnë besimin e qytetarëve. Asgjë nuk do të arrijmë nëse nuk e fitojmë besimin e qytetarëve. Është qytetari ai që e lufton krimin, jo policia. Polici nuk mund të ndodhet në çdo vend. Nëse ndodh një krim në një vend dhe nuk janë qytetarët aty, nuk janë dëshmitarët, ai krim nuk do të zbulohet kurrë.

Cilat janë planet tuaja dhe cilat mendoni se do të jenë sfidat e ardhshme në vitet në vijim në lidhje me mbikëqyrjen parlamentare?

Maloku: Po përpiqemi ta ngrisim një komision në Parlament të Kosovës, i cili do të ketë rregullore, emërtim dhe fushë-veprim të qartë, se ku është fushë-veprimi i atij komisioni. Do të përpiqemi që përvoja të cilat po marrim nga mekanizmat ndërkombëtarë OSBE-së, DCAF-it, dhe kontakteve nga vizitat e ndërsjella me parlamentet dhe komisionet homologe të parlamenteve të vendeve të ndryshme, që ato përvoja t'i inkorporojmë në rregulloren e punës së komisionit dhe fushëveprimin e atij komisioni. Do të jetë një komision që do t'i kryej detyrat ashtu si është më së miri.

MPB do të bashkëpunoj me Kuvendin në ngritjen e një arkitekture të qëndrueshme të sigurisë

Intervistë me Fatmir Rexhepin, Ministër i Punëve të Brendshme

ASI: Cilat janë tri sfidat kryesore me të cilat ballafaqoheni për momentin, përmirësimi i së cilave do të bënte që Ministria e Punëve të Brendshme të funksionojë më mirë?

Rexhepi: Mund të shtoj që çdo ministri në fillimet e saja i ka vështirësitë e caktuara. Ne jemi në fazën fillestare. Ndër angazhimet apo sfidat e para, do të kisha vendosur ndërtimin e hapësirave të nevojshme për pune dhe vendosja e kuadrit qoftë e ministrisë me kabinetin e tij. Pastaj, vendosja e bashkëpunëtorëve nga stafi ndërkombëtar - që janë më së të nevojshëm dhe të domosdoshëm për të ofruar asistencë profesionale. Së treti, vendosja e departamenteve të reja, administratës e cila duhet të ngrihet në kuadër të ministrisë së brendshme. Tashmë po përfundon edhe muaji i tretë dhe ende nuk kemi mundur të dalim në lokalet e reja, qoftë ne si kabinet i ministrit, qoftë si administratë e cila është në pranim e sipër, pasi që kemi vonesa vërtetë të pakuptimta prej mënyrës, procedurave rreth rregullimit të atyre objekteve.

Përveç kësaj, çështje dytë për në është çështja e vetë ministrit, dhe e kabinetit tonë që në ngritjen e kapaciteteve humane dhe kapaciteteve të punës, pra të përfundojnë me konkurse nga të cilat presim që të kemi njerëz sa më profesional dhe njerëz që do t'i përgjigjen sektorëve dhe specifikave këtu në kuadër të drejtorive apo departamenteve përkatëse.

Dhe e treta është çështja e përmbushjes së standardeve. Gjithnjë duke e pasur parasysh këtë kapacitet i cili i nevojitet ministrisë që ato të realizohen sa më shpejtë. Në kuadër të kësaj kemi hartimin e projekt-ligjeve sipas prioriteteve që duhet të përfundojnë brenda këtij viti. Ne i kemi caktuar që të jenë Ligji për Policinë, Ligji për Pasaportën, apo Dokumentin e Udhëtimit, Ligji për Letërnjoftimin, Ligji për Emrin. Për më tepër, bashkë me bartjen e autorizimeve të reja që vijnë në kuadër të SHPK-së - e cila ka kaluar një pjesë por jo e gjitha - do të kemi të drejtën e mbikëqyrjes dhe një relacion më të afërt të bashkëveprimit në planin e punës siç është e përcaktuar në detyrat dhe përgjegjësi e Shërbimit Policor të Kosovës, i cili edhe më tutje vazhdon të menaxhohet plotësisht nën komandën e Komisionarit të Policisë.

ASI: Cilat janë përshtypjet tuaja për zhvillimin e Ministrisë që prej se keni marrë postin?

Rexhepi: Shikuar mbi bazën reale të kushteve dhe konditave, unë si ministër me stafin tim kemi punuar që plani i veprimit dhe vetë faza e dytë e bartjes së përgjegjësi nëpër ministri të jetë e matur dhe pozitive. Sa i përket përmbushjes së detyrave nga ana e Ministrisë në këto kushte çfarë i kemi si realizimi i pjesës fillestare të konkurseve për të gjitha departamentet duke përfshirë këtu edhe Sekretarin

Permanent, Inspektoratin e Policisë, janë në përfundim e sipër.

ASI: Cilat do të jenë shtyllat dhe funksionet e MPB-së përveç SHPK-së?

Rexhepi: Për MPB-në është hartuar një draft i parë i skemës së organizimit në kuadër të së cilës, varësisht nga progresi që e arrijmë brenda këtij viti, do t'i kemi edhe institucionet e tjera të cilat janë ndërtuar para se të themelohet Ministria dhe do t'i takojnë MPB-së. Pra do të menaxhohen nga MPB-ja, jo vetëm të mbikëqyrren. Mbikëqyrja është diçka me një distancë tjetër, por të menaxhohen dhe të udhëheqin strategjinë e tyre e punës. Në kuadër të saj, ne e kemi bie fjala Akademinë Policore ose Akademinë për Zhvillimin e Kuadrove në Vushtrri, kemi ngritjen siç thashë të Inspektoratit të Policisë, nëntë departamente, dy nga të cilat tashmë i kemi marrë nga Ministria e Shërbimeve Publike dhe shtatë të tjera janë në ndërtim e sipër në kuadër të Ministrisë dhe bashkë me këto do të vjen edhe Shërbimi Policor i Kosovës i cili e ka një nomenklaturë dhe një strukturë të organizuar me vite. Ndërsa, sa i përket një agjencie informative apo diçka ngjashëm, kujtoj që se ende nuk është me ndonjë prioritet për këtë moment. Por, ndoshta në një kohë tjetër ajo do të organizohet dhe do të mbikëqyret apo do të formohet sipas nevojës, dhe në bashkëpunim me Qeverinë,

do të kemi një agjenci, e cila me informacione është në dobi të vetë punës sonë dhe programit të qeverisë dhe institucioneve të tjera si një preventivë e nevojshme për funksionimin dhe luftimin e atyre dukurive të cilat e dëmtojnë shoqërinë.

ASI: Si e shihni pozitën tuaj në mes të Policisë dhe Kuvendit? Si qëndrojnë raportet tuaja profesionale me këto dy institucione?

Rexhepi: Ekziston një bashkëpunim i cili duhet të vazhdoj, normalisht me komisionet parlamentare të cilat e përcjellin punën që ka të bëjë me rendin, me sigurinë, me strukturat e sigurisë në Kosovë, në kuadër të kësaj edhe me punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Vlerësoj se bashkëpunimi duhet të thellohet mënyrë të veçantë në dy çështje: në çështjen e përgatitjes sa më të mirë të projekt-ligjeve, dhe çështja e dytë lidhet me ndërtimin e një debati parlamentar ose rekomandimeshparlamentarë ngritjen e besimit, në ngritjen e një arkitekture të sigurisë që do të jetë e përshtatshme dhe e nevojshme në faza të tjera për Kosovën.

ASI: SHPK-ja gëzon një reputacion të mirë në rajon. Çka mund të bëni që të vazhdohet me mbajtjen e këtij standardi që ka arritur bashkësia ndërkombëtare?

Rexhepi: Në radhë të parë unë do të falënderoja të gjithë ata që kanë kontribuar në udhëheqjen



Minister Fatmir Rexhepi

e Akademisë dhe ngritjen e shkollimin e të gjithë brezave ose të kuadrove të këtyre gjeneratave. Këtu në mënyrë të veçantë do ta falënderoja Drejtorin Steve Bennet, i cili që shtatë vite udhëheq me shumë sukses një akademi. Unë tek Policia e Kosovës e kam një besim shumë të madh dhe të plotë ngase ata janë të përkushtuar të kryejnë detyrat e tyre me një sakrificë, me një disiplinë në mënyrë që të kontribuojnë për qytetarët e vendit të vet, që të kenë një lëvizje të lirë, t'iu garantohet pasuria, t'iu garantohet liria e qarkullimi. Policia ka vërtetuar në vazhdimësi se

është shërbim që e do vendin e vet, e cila i njeh qytetarët e vet, e cila është duke kërkuar që të marrë përgjegjësitë e veta dhe të tregojë edhe me shumë rezultate në luftimin e të gjitha dukurive negative të një shoqërie që ekzistojnë. Për më tepër, policia ka dëshmuar që më lehtë komunikon me qytetarin në gjuhën e tyre, e njohin rrethin apo fshatin, lagjen, qytetin, njerëzit dhe unë shpresoj se këtu do të ketë rezultate edhe shumë më të mëdha gjatë bartjes së përgjegjësive tek autoritetet e policisë në të gjitha nivelet. Normalisht kjo kërkon një mbikëqyrje të mirë, një stimulim

edhe më të mirë, një logjistikë më të mirë të punës.

ASI: Sa është korrupsioni problem brenda SHPK-së krahasuar me institucionet e tjera dhe si mendoni të tejkalohen këto probleme?

Rexhepi: Nuk ka asnjë shoqëri në botë e cila nuk lëngon nga korrupsioni. Tash edhe ne vetëm të bëjmë një marketing në frymë negative se ka korrupsion të madh në këtë ose atë institucion nuk është në rregull. Unë mendoj që është një dukuri që mund të jetë prezente, por kujtoj që është në përmasa shumë të vogla. Dhe këtë që e them jam shumë i rezervuar për arsye se unë nuk i kam as argumentet për atë. Por, edhe nëse ka një incident të vogël nuk duhet stërmadhuar por duhet që të pengohet, të bëhet preventiva dhe të merren masa adekuate. Unë kujtoj që kjo më së pakti është evidente te Shërbimi. Nëse e bëjmë një krahasim me institucionet - unë këtë e kam dëgjuar edhe vetë - njerëzit kanë besim të plotë tek institucioni i Shërbimit Policor i Kosovës. Por si dukuri, aty ku ekziston, duhet të argumentohet dhe të luftohet fuqishëm. Edhe krimin, edhe korrupsionin edhe ato elemente tjera deviante.

ASI: Çfarë është gjendja në ndërtimin e autoriteteve kompetente në fushën e azilit dhe të të kthyerve brenda Ministrisë?

Rexhepi: Ekziston departamenti i cili duhet të merret në mënyrë të veçantë, drejtoria e cila merret më çështjen e kufijve. Kështu që meqenëse ne ende nuk i kemi njerëzit, nuk mund të themi se kemi bërë diçka praktike. Por është

ajo pjesë e organizimit në kuadër të organogramit dhe ne posa ta plotësojmë stafin në këtë departament, ai do të jetë i cili merret ekskluzivisht me çështje të cilat janë të nevojshme për t'u shtruar para Ministrisë por edhe para Kuvendit për vendime të tjera që kanë nevojë njerëzit të dinë statusin e tyre brenda këtu si dhe çështje tjera që i preokupojnë ata.

ASI: Emërimi i shërbyesve civil në administratë dhe në polici duhet të jetë i bazuar në kualifikimet e atyre personave. Si qëndron situata në këtë drejtim në Ministrinë tuaj dhe si mund që të siguroni në të ardhmen që një mekanizëm i tillë do të jetë efikas?

Rexhepi: Unë e kam qëndrimin tim të prerë sa i përket kriterëve dhe parimeve se si duhet të jetë e drejta e njerëzve që të përzgjidhen për një vend pune apo si të shpallen konkurse. Ka pasur raste kur 2-3 konkurse, të cilat pa dijeninë time kanë dal në shtyp, dhe në to është kërkuar për kualifikimi: shkolla e mesme, shkolla e lartë, fakulteti. Pasi jam njoftuar unë i kam anuluar ato se është absurde në ditët e sotme të ketë një vend pune ku kërkohet edhe shkolla e mesme edhe fakulteti. Nëse është vendi për fakultet pra le të ceket për fakultet dhe le të konkurrojnë ata që i kanë dhe i plotësojnë këto kushte. Prandaj, do të jemi shumë të kujdesshëm në këto raste që të mos ndodhin të tilla gjëra por të bëhet kategorizimi i vendeve të punës, në pajtim me detyrat e punës të cilat i përkasin një vendi për të cilat ka ekspertë që i kanë shkruar – nuk jam unë ai që e kam bërë përshkrimin e atyre vendeve.

Përshtypjet nga vizita në Parlamentin e Republikës së Sllovenisë

Husnije Beshkoviq, Zëvendëskryetare e Komisionit për Gatishmëri Emergjente

Me 15 deri me 17 maj 2006, morra pjesë në vizitën e delegacionit të Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë të Kuvendit të Kosovës në Parlamentin e Republikës së Sllovenisë. Delegacioni ynë përbëhej nga 7 anëtarë dhe udhëhiqej nga z. Naim Maloku, kryetar i komisionit dhe njëherësh anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Vizita u organizua nga Departamenti i Demokratizimit i Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe z. Kim Vetting me bashkëpunëtorët e tij. Kjo ishte vizita e parë në vazhden e vizitave që ky komision i Kuvendit të Kosovës ka planifikuar t'u bëjë komisioneve parlamentare homologe të vendeve të rajonit. Fjala vjen, për qershor të këtij viti janë planifikuar vizitat në parlamentet e ish RF të Maqedonisë dhe në Bosnje Hercegovinë.

Qëllimi i vizitës në Parlamentin e Sllovenisë ishte që të zgjerohet dhe thellohet bashkëpunimi midis deputetëve të Parlamentit të Kosovës dhe të Sllovenisë, e në veçanti që të shkëmbehen përvoja dhe mbahen konsultime për punën e Komisionit për Siguri, si dhe për mekanizmin mbikëqyrës të Kuvendit mbi ministrinë dhe zyrat përkatëse.

Delegacioni ynë zhvilloi një sërë vizitash të rëndësishme me zyrtarë të lartë të institucioneve të larta sllovene. Me këtë rast delegacioni ynë zhvilloi një takim me Komisionin e Parlamentit të Sllovenisë për Marrëdhënie të Jashtme, që kryesohet nga kryetari i saj Jozef Jerovsek, Sekretarin e Shtetit në Ministrinë për Punë të Brendshme Zvonko Zinrajin, dhe Karlo Erijavec

nga Ministria e Mbrojtjes. Veç këtyre, ne zhvilluam biseda të rëndësishme edhe me përfaqësuesit e Armatës sllovene dhe të shërbimit të inteligjencës dhe sigurisë nga Ministria e Mbrojtjes, sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit Lovro Loncarin, kryetarin dhe anëtarin e Komisionit për kontrollin e shërbimit të inteligjencës dhe sigurisë, si dhe me z. Janez Zhirovnikun, zëvendës drejtor i përgjithshëm i agjencisë sllovene të inteligjencës dhe sigurisë.

Me këtë rast do të doja të them diçka për përshtypjet e mia dhe për përmbajtjet e këtyre vizitave. Sipas mendimit tim - dhe madje jam e bindur se edhe anëtarët e tjerë të delegacionit janë të njëjtit mendim - vizita ishte shumë e suksesshme dhe e dobishme si për deputetët e Kosovës ashtu

edhe për anëtarët e Komisionit për Gatishmëri Emergjente. Kontaktet e para me kolegët nga Parlamenti slloven ishin shumë mbresëlënëse, ngase u befasuam me pritjen e ngrohtë dhe miqësore.

Gjatë takimeve të punës me zyrtarë të lartë, të sipërpërmendur, ne patëm rastin të informohemi për çështje që janë jashtëzakonisht të dobishme për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova tani gjatë vitit 2006.

Është me rëndësi të vihet në dukje se nikoqirët u interesuan për situatën aktuale në Kosovë, procesin e negociatave, situatën e sigurisë, integrimin e minoriteteve në shoqërinë kosovare, funksionimin e institucioneve të Kosovës, dhe për kushtet e përgjithshme ekonomiko-shoqërore.

Ne zhvilluam biseda transparente dhe shteruese ku diskutuam jo vetëm për përvojat e punës në Komisionin për Siguri, por edhe për mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare në Parlamentin Slloven. Ajo që ishte me rëndësi për delegacionin tonë nga Kosova ishte se ne kuptuam që mbikëqyrja parlamentare dhe puna e komisioneve parlamentare është e rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore të miratuara nga Parlamenti i Sllovenisë.

Interesimi ynë dhe pyetjet tona u përqendruan në organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme,



sistemit policor dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë. Ne i pyetëm zyrtarët sllovenë se: Kush ka të drejtë t'i mbikëqyrë këto institucione të rëndësishme? Çfarë kompetencash kanë komisionet parlamentare në procesin e mbikëqyrjes?

Ndërsa, pala mikpritëse u përgjigj përzemërsisht në të gjitha pyetjet tona dhe sqaroi se si janë të rregulluara këto çështje me ligj dhe se si zbatohen ato. Me këtë rast, ata na dhanë shumë dokumente dhe materiale, që do të jenë shumë të dobishme për punën tonë të mëtejme në Kosovë.

Po kështu, në kuadër të programit, ne vizituam edhe ndërtesën e Parlamentit slloven si dhe sallën ku mbahen seancat plenare të Kuvendit.

Do theksuar se delegacioni ynë pati rastin të njihet me kushtet dhe mënyrën e punës së Parlamentit slloven dhe të konstatojë me kënaqësi se ata i përmbahen standardeve më të larta Evropiane gjatë punës së tyre.

Kujtoj që vizitat e këtilla janë shumë të dobishme për ne deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe se shkëmbimi dhe marrja e përvojave, në veçanti nga shtetet fqinje është shumë me rëndësi për ne. Ato kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie moderne demokratike në Kosovë. S'do mend se kjo është vetëm një nga shumë takime dhe vizita, në kuadër të projekteve shumë të dobishme, që organizon Misioni i OSBE-së në Kosovë për të promovuar zhvillimin dhe demokratizimin e shoqërisë kosovare.

Mendoj se vizita ka qenë e suksesshme.

Zhvillimi i programit profesional për mbikëqyrjen parlamentare të shërbimeve të sigurisë

Kim Vetting, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, z. Petersen shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 2005/ 53 për krijimin e Ministrisë për Punë të Brendshme si organi i parë i sigurisë në degën e ekzekutivit të Institucioneve të Vetëqeverisjes së Përkohshme (IPVQ), Kuvendi i Kosovës veç e kishte iniciuar debatin e brendshëm për mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Duke i parashikuar këto zhvillime, Misioni i OSBE-së në Kosovë qysh në nëntor kishte filluar me Programin për Zhvillimin Profesional për Mbikëqyrjen Parlamentare të Sigurisë.

I mbështetur nga fondacioni për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) me seli në Gjenevë, programi i OSBE-së përqendrohet kryesisht në punën me Komisionin e Kuvendit për Gatishmëri Emergjente, ndonëse në program janë ftuar të marrin pjesë edhe deputetët tjerë dhe kryesues të grupeve parlamentare të Kuvendit. Programi ka për qëllim që të promovojë bashkëpunimin rreth projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme si me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme ashtu edhe me ata të Zyrës për Siguri Publike të Kryeministrisë. S'do mend se programi ka për qëllim që t'i përfshijë të gjitha grupet etnike në Kuvend, përfshirë këtu edhe serbët e Kosovës.

Në tryezën e parë të rrumbullakët, ku morën pjesë zyrtarë të nivelit të lartë, në nëntor të vitit 2005 në Hotel Grand u adresuan parimet e

përgjithshme të mbikëqyrjes parlamentare të policisë dhe sektorit të sigurisë. Me këtë rast, diskutimet nxorën në pah faktin se në shoqëritë demokratike, pushteti i zgjedhur përmes votës së lirë është ai që ka monopol legjitim ndaj përdorimit të forcës, së këtejmi policia është drejtpërsëdrejti përgjegjëse ndaj pushtetit. Po kështu, Kuvendi mban përgjegjësi Qeverinë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë; dhe shqyrton dhe autorizon buxhetin për policinë dhe sektorin e sigurisë. Njëherësh, me këtë rast, u theksua se sipas definicionit policia dhe sistemi gjyqësor duhet të mbesin politikisht neutrale.

Me 1 mars, Komisioni i Kuvendit vizitoi sektorin e monitorimit të brendshëm të Shërbimit Policor të Kosovës: Inspektoratin e Policisë së Kosovës (IPK), që aktualisht ndodhet në Fushë Kosovë (më tepër informata lidhur me IPK-ën mund të lexoni në artikullin tjetër të këtij edicioni të buletinit informativ). Ndërsa, një ditë më parë deputetët e Kuvendit vizituan Shkollën Policore, me ç'rast u informuan më për së afërmi mbi zhvillimet e reja në procesin e transformimit të kësaj shkollë në Akademi të Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (KAPSED).

Me 10 mars, z. Fatmir Rexhepi u emërua nga IPVQ-ët si Ministri i parë i Punëve të Brendshme. Së këndejmi, pas këtij hapi të rëndësishëm, OSBE-ja organizoi një seminar dy ditor ku morën

pjesë anëtarët e Komisionit, Ministri dhe stafi i tij kryesor, si dhe përfaqësues të Shtyllës së UNMIK-ut për Polici dhe Drejtësi, për të diskutuar rreth bazës ligjore dhe buxhetore të ministrisë.

Po kështu, vlen të vihet në dukje se gjatë dy muajve të fundit, Komisioni i Kuvendit ka bashkëpunuar me komisionet homologe nga vendet e tjera të Evropës Juglindore për t'u njohur me praktikën më të mira të mbikëqyrjes parlamentare në këtë fushë. Kështu, me 15 deri me 17 maj, Komisioni ka vizituar Lubjanën, ndërsa me 5 dhe 6 qershor Komisioni vizitoi edhe Shkupin. Gjatë këtyre dy vizitave ne patëm rastin të marrim informata jashtëzakonisht të dobishme mbi mësimet e mësuara dhe praktikën më të mira nga rajoni. Veç kësaj, përmes një projekti të financuar nga Agjencia Evropiane për Rekonstrukcion për Kuvendin, një ekspert për çështje të sigurisë nga Parlamenti francez do ta vë në dispozicion ekspertizën e tij për këtë Komision të Kuvendit. S'ka pikë dyshimi se përmes këtyre kontakteve bilaterale, dhe sidomos në Konferencën Rajonale për Mbikëqyrje Parlamentare të Sigurisë, që do mbahet me 25 deri me 27 qershor, në organizim të përbashkët me DCAF-in, do të bëhet e mundur që Kuvendi i Kosovës ta ridefinojë rolin e këtij komisioni funksional, që merret me çështje të sigurisë, duke u përgatitur shumë më mirë për sfidat e procesit të mbikëqyrjes së strukturave të sigurisë së IPVQ-ve, që janë duke u zhvilluar vazhdimisht.

"SHPK-ja i nënshtrohet ligjit dhe e zbaton atë"

Intervistë me kolonel Sheremet Ahmetin, zëvendës-komisionar i Shërbimit Policor të Kosovës

ASI: Si e shihni rolin e policisë si shtyllë kryesore e sistemit të sigurisë?

Kolonel Ahmeti: Pa dyshim se Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) ka rol të rëndësishëm në krijim e sigurisë së vendit. SHPK është shërbim i ri relativisht, për këto 6 vite, ka arritur të krijojë mëvetësinë e vet. Ajo sot ka mbi 7000 pjesëtarë në gjirin e saj, është multietnike, multi-gjinore, është në fazën e përfundimit të tranzicionit të saj. Si e tillë, është e përkrahur dhe e mbështetur nga vetë populli dhe institucionet Kosovare. Ne punojmë vazhdimisht në krijimin e një mjedisi të sigurt për qytetarët dhe luftimin e krimit. Kuptohet se kontribut të veçantë në këtë fazë ka dhënë policia ndërkombëtare, me mbështetjen e tyre, me trajnimin e tyre dhe si rezultat i asaj, ka ardhur në fazën përfundimtare të tranzicionit të policisë së vendit. Jemi një shërbim për tërë Kosovën, të ndarë në 8 territore, jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe institucioneve, vendore dhe ato ndërkombëtare..

KSI: Çfarë mendoni për funksionimin aktual të mbikëqyrjes së Kuvendit? Çfarë është puna e juaj dhe a shihni ndonjë mënyrë për të bërë atë me efikas?

Kolonel Ahmeti: Ne kemi raporte të mira me të gjitha institucioneve të vendit, jemi pjesë e institucioneve të vendit, kuptohet jemi ende në kuadër të policisë së UNMIK-ut, por shpresojmë se me bartjen e përgjegjësive të plota

në institucionet e vendit do të jemi pjesë e Ministrisë së Rendit. Gjithashtu, jemi organ ekzekutiv, pra zbatojmë ligjin dhe jemi në funksion të Ligjit.

ASI: Çfarë mendoni për raportet ndërmjet SHPK-së dhe institucioneve të ngjashme si TMK, KFOR apo policia ndërkombëtare?

Kolonel Ahmeti: Ne kemi raporte të mira me të gjitha institucionet e vendit, dhe në rast të emergjencës ne jemi në aksione të përbashkëta dhe kuptohet në rast të emergjencës ne jemi bashkë me TMK-në dhe të gjithë të tjerët në realizimin e objektivave dhe detyrave tona. Bashkëpunimi është i mirë, në radhë të parë me policinë e UNMIK-ut, si pjesë e saj, por edhe me policitë tjera fqinje, ne kemi takime me të gjithë fqinjët përveç me policinë e Serbisë, d.m.th. me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi. Ne mendojmë se edhe me Serbinë duhet të kemi kontakte, bashkëpunim dhe koordinim. Shpresojmë se në të ardhmen do të ndërtohen raporte profesionale edhe me Serbinë, si dhe fqinjët tjerë.

ASI: Periudha tranzitore, ku SHPK është duke e marrë përsipër përgjegjësin është në përfundimi e sipër. Si e shihni procesin në përgjithësi dhe posaçërisht në Shtab (qendër) ku më parë kanë munguar burimet njerëzore?

Kolonel Ahmeti: Ne kemi pasur bartje të përgjegjësive në të gjitha stacionet policore, në regjionet urbane 33 stacione policore, kontrollojmë 5 regji-



Kolonel Sheremet Ahmeti me Kryeministrin Çeku dhe Kryesuesen e Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjinaze Syla

one kryesore, përveç regjionit të Mitrovicës, ku presim se shpejti të bëhet bartja e përgjegjësive. Kohëve të fundit është bërë emërimi i gradave të larta. Përveç Komisarit Vitrup, të gjithë të tjerët janë në cilësinë e këshilltarëve. Unë jam zëvendës-komisionar i SHPK, i kam 4 asistentët e mi në fushat e ndryshme si njoftimit, krimit, operimeve, policisë kufitare dhe administratës. Pra, tranzicioni është në fazën përfundimtare, ndërsa sa i përket çështjes së kuadrove, ne kemi burime njerëzore, kemi përgatitur njerëz të cilët tani që 7 vite kanë krijuar eksperiencë. Kuptohet nuk kemi mundur të krijojmë mekanizëm plotësisht funksional për këtë periudhë. Sigurisht se në të ardhmen do të kemi nevojë për trajnime shtesë, specializimeve të ndryshme të larta. Ne këtë hap i kemi parashtruar vetes, së bashku me komisarin Vitrup dhe institucionet e vendit.

ASI: Çfarë është statusi i njësisë për standarde profesionale, emërtimi i policëve të lartë, komisioni disiplinor dhe inspektorati policor? A janë ata duke punuar, dhe sa janë ata funksional, a jeni ju i kënaqur me punën e tyre?

Kolonel Ahmeti: Do të përqendrohem vetëm për njësinë e standardeve profesionale, të tjerat janë në kuadër të Ministrisë së Rendit, pra Qeverisë. Kjo njësi është përgjegjëse për mbajtjen e standardeve të policisë. Natyrisht se gjatë punës së policisë ndodhin gabime, por në mënyrë që ato të mos përsëriten dhe të ndikojmë në mënyrë preventive të tjerët të mos bëjnë gabime të tilla, ato janë të sanksionuara. Masa disiplinore shprehen ndaj çdokujt që argumentohet që ka bërë faj. Te ne nuk ka përjashtime, si polici, togeri, koloneli. Nëse ka fakte dhe

argumente, të gjithë rastet hetohen dhe merren masa të parapara disiplinore. Nëse ka elemente, ngrihet edhe procedura kriminale në institucionet përkatëse - gjyq.

ASI: Kuvendet komunale kanë propozuar tre kandidatë për udhëheqës lokal të policisë. Çfarë është përshtypja juaj rreth përzgjedhjes, a janë ata duke punuar mirë?

Kolonel Ahmeti: Në bazë të Rregullores 2005/54, është përcaktuar se komisar i policisë, së bashku me mua dhe ministrin, kuvendin komunal ia propozon tre kandidatë. Kryetarët e komunave kanë rast të përcaktohen për atë

që mendojnë që është më i përshtatshëm dhe kryen punën më mirë. Kjo rregullore është duke u zbatuar prej dhjetorit 2005, deri më tani kemi raporte të mira me kuvendet komunale, që shpresojmë se do të vazhdojnë.

ASI: A ka pasur raste, ku në fund gjyqi ka ndërhyrë në vendimin final ndaj masave të ndërmarra ndaj ndonjë zyrtari?

Kolonel Ahmeti: Është e drejtë e gjykatës të ndryshojë ndonjë vendim të njësisë së standardeve profesionale. Ne jemi obliguar të respektojmë. Është e drejtë e policit të dënuar të ankohet dhe nëse

gjykata vendos se ka pasur parregullsi, ia kthen vendimin e njësisë së standardeve profesionale dhe ne jemi të obliguar që ti përmbahemi.

ASI: Si po funksionon mekanizmi i brendshëm në lidhje me kundërvajtjet nga ana e zyrtarëve të SHPK-së?

Kolonel Ahmeti: Ne jemi shërbim publik, zbatues të ligjit dhe normal që duhet të jemi shembull për të tjerët qysh duhet respektuar atë. Rastet e shkeljeve hulumtohen nga njësia e standardeve profesionale dhe ndërmerren masa kundër të gjithë atyre që bëjnë veprime të tilla, në

përputhje me Rregulloren 2005/54.

ASI: Për momentin kush e bënë mbikëqyrjen financiare dhe kush do ta bëjë në të ardhmen?

Kolonel Ahmeti: Buxheti jonë varet nga Qeveria, pra buxheti i konsoliduar i Kosovës. Menaxhimi i deritanishëm i buxhetit është bërë nga ndërkombëtarët, besoj që së shpejti kjo kompetencë do të kalojë te zyrtarët e lartë vendor, pra te asistenti im për çështje të administratës. Mendoj se në bashkëpunim me Qeverinë dhe Ministrinë, do të ishte plotësisht e drejtë që ne të menaxhojmë me buxhetin.



Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu, Kolonel Sheremet Ahmeti dhe Komisioneri i Policisë, Kai Vitrup

Mbikqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë

Peter Vanhoutte, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Parlamentet e porsakrijuara shpenzojnë një kohë të konsiderueshme në miratimin e legjislacionit, ngase kjo është një gjë e domosdoshme, dhe kjo është çfarë pritet zakonisht nga parlamentet. Fatkeqësisht, ka tendencë të harrohet se gjëja më e rëndësishme se sa hartimi dhe miratimi i legjislacionit është kujdesi më i veçantë ndaj mirëmbajtjes së demokracisë dhe popullit.

Kohëve të fundit, Kuvendi i Kosovës ka kuptuar se mbikqyrja parlamentare është me të vërtetë aktiviteti thelbësor i një parlamenti të mirëfilltë. Një mekanizëm i rëndësishëm për ushtrimin e mbikqyrjes gjatë seancave plenare është caktimi i kohës së parashikuar për pyetje. Disa komisione, përveç seancave plenare, e kalojnë kohën më të madhe duke e mbikqyrrur qeverinë. Një rast

shumë specifikë është roli i Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë, që është kompetentë për mbikqyrjen e policisë, sigurisë dhe strukturat e sigurisë. Krijimi i Ministrisë së re për Punë të Brendshme në kuadër të IPVQ-ve, para disa muajsh, i ka ofruar disa mundësi të shkëlqyeshme këtij komisioni për të bërë trajnime shtesë mbi metodat për mbikqyrje, në Kosovë dhe jashtë. Si rezultat i këtij trajnimi, dhe duke iu falënderuar kryesuesit shumë të aftë z. Naim Maloku, deputetët janë vetëdijuesar se sa sfiduese është organizimi i mbikqyrjes efikase. Përkundër vështirësive është e nevojshme të garantohet me çdo kusht, që policia dhe strukturat e sigurisë të zhvillohen në struktura të vërteta demokratike.

Përgjegjësia

Në shoqërinë demokratike, shërbimi policor i përgjigjet tri degëve të qeverisë: legjislacionit (parlamentit apo kuvendit), ekzekutivit (qeverisë) dhe gjyqësisë (gjykatave). Në nivelin qendror dhe lokal, qeveria ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi shërbimin policor, duke përcaktuar buxhetin, udhëzimet për operime dhe prioritetet e tyre. Dega legjislative ushtron mbikqyrje parlamentare, duke hartuar dhe miratuar legjislacionin, i cili përkufizon dhe rregullon shërbimin policor dhe kompetencat, si dhe miraton buxhetin e nevojshëm. Policia i përgjigjet drejtpërsëdrejti ministrit përkatës qeveritar, dhe kështu radhazi ministri i përgjigjet parlamentit, deputetët e të cilit i përgjigjen elektoratit. Sipas

përvojës sonë, parlamentarëve të rinj i nevojitet së paku dy deri tre vite për ta mësuar përdorimin e teknikave themelore të mbikqyrjes siç janë: parashtrimi i pyetjeve, interpelancat, mocionet, debatet, dëgjimet, vizitat, kontrollimi i buxhetit dhe shqyrtimi i legjislacionit.

Mirëkuptimi i ndërsjellë

Zhvillimi i mbikqyrjes efikase të sektorit të sigurisë është sfidë për të dyja palët, për parlamentet dhe qeveritë. Ndonëse, që të dyja këto duhet të luajnë role të ndryshme, ato po ashtu janë përgjegjëse për funksionimin e sektorit të sigurisë dhe aftësisë së tij për të siguruar shoqëri të qëndrueshme dhe të sigurt. Për ta arritur këtë, parlamenti nuk duhet vetëm të monitoroj



qeverinë dhe policinë, por edhe duhet ta miratoj dhe mbështesë zbatimin e duhur të politikave koherente të sigurisë dhe legjislacionit të duhur. Mbikëqyrja e tillë do të qoj në një dialog intensiv dhe mirëkuptim të ndërsjellë ndërmjet qeverisë, institucioneve të sigurisë dhe kuvendit.

Çdo shoqëri që kërkon ta mbështesë sundimin e ligjit, atëherë mbikëqyrja parlamentare dhe qeveritare e policisë duhet të bazohet në një sërë parimesh. Në shoqërinë demokratike, zakonisht autoritetet shtetërore kanë monopolin legjitim të forcës. Kjo do të thotë se përveç policisë, qytetarët (përfshirë këtu kompanitë e sigurimit dhe paraushtarake) nuk kanë të drejtë t'i përdorin armët për përdorim të dhunës, kundër bashkëqytetarëve të tyre. Qytetarët mund të mbështeten në shërbimin policor dhe kurdo që ata të kërcënohen seriozisht nuk duhet të përdorin ndonjë armë, veç nëse posedojnë leje speciale për të.

Përdorimi i forcës nga autoritetet kompetente duhet të monitorohet për së afërmi, në mënyrë që të shmangët devijimi nga politikë e qeveritare. Policia drejtpërsëdrejti i përgjigjet qeverisë, përmes ministrit përkatës (zakonisht ministrit të punëve të brendshme). Kështu radhazi parlamenti i përgjigjet qeverisë, e cila siguron zhvillimin e politikave të policisë dhe bënë rishikimin, nëse dhe si zbatohen e respektohen politikat në terren. Për kryerjen e kësaj është kruciale mbledhja dhe analiza e të dhënave të sakta statistikore: kuvendi duhet të jetë në gjendje të kontrolloj buxhetin dhe shpenzimet e

policisë, si edhe vlerësimin e të dhënave të punës së policisë.

Pa politikë

Deputetët e Parlamentit apo sytë dhe veshët e qytetarëve, duhet gjatë tërë kohës të verifikojnë, që policia i zbaton parimet e qeverisjes së mirë dhe sundimin e ligjit. Megjithatë, përveç komisioneve hetimore, shërbyesit civil (duke përfshirë policët) kurrë nuk duhet ti përgjigjen drejtpërsëdrejti parlamentit – zyrtarët e policisë askurrë nuk duhet të japin llogari para komisionit. Ndonëse, zyrtarët e policisë dhe shërbyesit civil mund të ftohen që të dalin para gjyqit në baza individuale gjatë ndonjë rasti kriminal.

Qeveria dhe kuvendi duhet ta dinë se në demokraci, shërbimi policor gjithmonë duhet të mbetet politikisht neutral. Brenda shërbimit policor nuk lejohen të bëhen emërim apo avancime politike. Ndonëse, është vështirë të zbatohet në mënyrë të drejtë nocioni i neutralitetit politikë, disa vende përpiqen të vendosin marrëveshje ndërmjet partive të ndryshme të rëndësishme politike, që ti ndajnë së paku pozitat më të larta (p.sh. Komisionari i policisë mund ti përket koalicionit kryesor të partneritetit në fuqi, e zëvendësi i tij të i përket partisë kryesore opozitare). Pothuaj në shumë raste zgjidhet e tilla rezultojnë me menaxhim të balancuar politikë.

Mbikëqyrja plotësuese

Përveç mbikëqyrjes së rregullt parlamentare, këtu gjithmonë do të ketë nevojë për struktura plotësuese mbikëqyrjeje nga jashtë. Këtu përfshihen institucionet e

ombudspersonit, komisionet parlamentare për peticione dhe këshilla për mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Këto organe të pavarura, po ashtu mund ta bëjnë hetimin e ankesave të qytetarëve. Gjyqësia kufizohet me rolin 'post factum' dhe kryesisht do të bëj ndjekjen penale të veprave të liga të policëve përmes ngritjes së padisë civile apo penale sipas nevojës. Mirëpo, gjatë tërë kohës duhet të respektohet rreptësishtë ndarja e degëve ndërmjet gjyqësisë, ekzekutivit dhe legjislativit.

Politikat e policisë

Politikat gjithpërfshirëse të policisë janë pjesë e politikave të sigurisë globale, që involvojnë të gjitha palët relevante të interesit dhe aspektet e sigurisë. Rishikimi I Sektorit për Siguri të Brendshme (RSSB) në Kosovë ka pikësynim zhvillimin e politikave të tilla. Për sa i përket Kuvendit të Kosovës, debati për politikat e sigurisë është pjesë e procesit dhe përbëhet prej katër fazave: zhvillimi, vendimmarrja, implementimi dhe evaluimi.

Parlamenti ka rol të kufizuar në fazën zhvillimit të sigurisë dhe politikat e policisë. Kjo detyrë i takon parlamentit kryesisht. Megjithatë, parlamenti mund të ngrit shqetësimet e publikut për çështjet e sigurisë dhe të kërkoj nga qeveria, që ti merr këto parasyshe që nga fillimi. Sigurisht, që qeveria duhet ta njoftoj këshillin për siguri dhe polici për zhvillimin e politikave që në fazën e planifikimit, kështu që ajo të mund të jep kontribut të dobishëm. Faza e vendimmarrjes është fazë ku parlamenti mund të luaj një rol të rëndësishëm,

posaçërisht lidhur me policinë dhe dokumentet e politikave për siguri dhe legjislacion. Në parim, kuvendi duhet të i diskutoj dhe miratoj politikat e reja dhe legjislacionin e hartuar nga qeveria. Në fazën e vendimmarrjes, parlamenti mund të ketë rol vendimtar përmes përvetësimit të buxhetit. Më së miri, involvimi i parlamentit do të qoj në rishikimin e politikave të propozuara dhe të rezultojë me dokumentin përfundimtar, që mund të merr pëlqimin e të gjithëve.

Këshilli kompetentë duhet të kërkoj që ta bëj mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe të vlerësoj efektin e vërtetë të politikave të miratuara dhe ta merr parasyshe kur të diskutohet për buxhetin e vitit në vijim.

Fitimi i mbështetjes publike

Parlamenti ka rolin kryesor kur vije te shtimi i përkrahjes publike për miratimin përfundimtar të politikave. Transparenca ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Debatet duhet të jenë publike sa më shumë që të jetë e mundur. Publiku, veçanërisht përfaqësuesit nga shoqëria civile duhet të inkurajohen për pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit dhe dëgjimet publike. Gjatë përgatitjes së mbledhjeve të komisionit, deputetët e parlamentit duhet të kujdesen për shqetësimet dhe pikëpamjet e të dy komuniteteve, atyre shumicë dhe pakicë, që të përkthehen dhe diskutohen në mënyrë të duhur.

Për komisionin për emergjencë dhe gatishmëri të kuvendit të Kosovës, realizimi i kësaj objektive do të jetë sfida kryesore për muajt në vijim.

Respektimi i ligjit dhe rregullave: Policia dhe të drejtat e njeriut në Kosovë

Dillon Case dhe Nikola Gaon, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK) është njëri ndër shërbimet më të reja policore në Evropë. I themeluar me 1999, detyra kryesore e tij është që të përkujdeset për rendin

publik dhe të zbatojë ligjin, por gjithnjë duke siguruar respektimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, kjo punë është më lehtë të thuhet se të bëhet.

“Njëra nga sfidat më të mëdha me të cilat ndeshemi është që të sigurohemi se një forcë policore relativisht e re i respekton standardet ndërkombëtare dhe kodet

procedurale të sjelljes,” vuri në pah Christopher Decker, Këshilltar për të Drejta të Njeriut dhe Çështje të Sigurisë në Misionin e OSBE-së në Kosovë.



Shumë oficerë të ShPK-së janë duke i thelluar njohuritë mbi kodin e procedurës dhe standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Rreshteri Atrim Myrtas nga stacioni policor i Gjilanit ka gjatë vite që është duke punuar në polici si hetues.

“Njeriu mëson deri sa të jetë gjallë,” potencoi Atrimi. “Ne çdo ditë i thellojmë njohuritë tona dhe përsosemi në profesionin dhe punën tonë.”

Mbingarkesa me informata

Kolegët ndërkombëtarë të Atrimit që punojnë në policisë civile të KB-ve dhe të cilët e monitorojnë punën e ShPK-së, pohojnë se mënyra e punës së tij është jashtëzakonisht profesionale. Megjithatë, shkeljet e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale dhe të drejtave të njeriut, ndonëse janë të rralla ato ende ndodhin.

Është e udhës të vihet në dukje se këto shkelje kryesisht kanë të bëjnë me arrestime, paraburgime apo hetime, trajtimin e adoleshentëve, lirisë së mbledhjes, apo me raportet midis policisë dhe mediave.

“Për t’i dalë zot detyrës si duhet, oficerët e policisë si Atrimi duhet t’i mbajnë në mend jo vetëm mbi 500 nene

të Kodit të Procedurës Penale, por edhe të gjitha dispozitat mbi të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me sjelljen e policisë,” sqaroi Christopher.

Dhe ndonëse Atrimi dëshiron ta kryejë punën “sipas rregullave”, ai ankohet se mbingarkesa me informata ia bënë të vështirë këtë.

Ndonëse trajnimet që i kanë ndjekur ai dhe mbi 7.000 kolegë të tij në Shkollën Policore – e cila drejtohet nga Misioni i OSBE-së- ua ka bërë të mundur atyre që të përgatiten mjaft mirë. Megjithatë, kur ata ndodhen në terren në detyrë, gjasat për gabime procedurale janë shumë të mëdha.

Broshurë për xhep

Për ta ndihmuar punën e policisë dhe për t'i zvogëluar mundësitë e shkeljeve, në muajin shkurt Misioni i OSBE-së në Kosovë ka botuar një broshurë xhepi me titull Të drejtat e Njeriut dhe Zbatimi i Ligjit: Një Broshurë mbi të Drejtat e Njeriut për Policinë.

Broshura bën të mundur që policët të kenë qasje dhe të pajisen me udhëzime lidhur me dispozitat më të rëndësishme të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale dhe standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Ajo është e ndarë në 18 kapitla tematike dhe ia bën të mundur oficerëve të policisë që t'i kërkojnë dhe gjejnë informatat kryesore për mbrojtjen e të drejtave të çdo individi.

Para se ta shpërndajë broshurën, Misioni ka bërë provë duke ua shpërndarë fillimisht një version të shkurtuar policëve vendor dhe ndërkombëtar të rajonit të cilin e mbulon stacioni i Atrimit- në rajonin



e Gjilanit, afro 40 kilometra në juglindje të Prishtinës- që është pritur shumë mirë.

Kopja e broshurës së Atrimit që dukej qartë se ishte shfletuar fakton se sa shpesh e ka konsultuar atë. “Unë gjithnjë e mbaj broshurën pranë vetes dhe sa herë që kam dilema e shfletoj për t'i kërkuar përgjigjet,” vuri në dukje ai. Ai shtoi se megjithatë konsideron se është shumë joprofionale që të konsultohet broshura gjatë procedurave, ndaj ai shfrytëzon çdo rast për t'i përsëritur udhëzimet.

Burim lehtë i qasshëm

Duke mbajtur me vete broshurën e cila përmban informata të shumta në formë të përmbledhur të një udhëzuesi të xhepit, oficerët do të kenë mundësi që të kenë qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në një burim të informatave që ia bën

të mundur atyre që t'i zgjerojnë njohuritë mbi procedurat.

Atrim pohon se do të donte që ta kishte një burim të këtillë informatash sa ka qenë rekrut. Por, për fat të mirë, kolegët e tij të sapo rekrutuar do ta kenë këtë mundësi dhe privilegj.

Së këndejmi, në muajin mars kopjet e broshurës në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze u janë shpërndarë të gjitha stacioneve policore dhe policëve nëpër tërë Kosovën. Pos kësaj, do të ketë edhe sesione të trajnimeve mbi çështjet e të drejtave të njeriut.

“Misioni shpreson se kjo përpjekje përmes metodës dhe mënyrës komplementare (plotësuese) të broshurës dhe të sesioneve të trajnimeve do të bëjë të mundur që policët t'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e të gjithë oficerëve të policisë dhe kësaj ta zvogëlojë numrin e shkeljeve të procedurës penale,” theksoi

Christopher Decker.

Përfituesit e vërtetë

Përfituesit e vërtetë, megjithatë, janë vetë kosovarët. Një forcë policore e informuar mirë jo vetëm për të drejtat e njeriut, por edhe për kodin e procedurës penale është shumë më e përgatitur që ta mbrojë popullatën e saj.

Me stabilizimin e situatës në Kosovë dhe me reduktimin gradual të rolit të ndërkombëtarëve në çështjet e sigurisë, oficerët e policisë si Atrimi dhe kolegët e tij të ShPK-së janë duke u shndërruar në shtylla të sigurisë publike.

Ndërsa, broshura dhe sesionet përcjellëse të trajnimit për policinë e Kosovës janë mjete jashtëzakonisht të rëndësishme, të cilat OSBE-ja dhe partnerët e saj ndërkombëtarë mund t'i shfrytëzojnë për ta mbështetur procesin.

OSBE-ja ndihmon shtimin e përkujdesit policor ndaj komunitetit në Kosovë

Nikola Gaon, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK-ja) dhe OSBE-ja janë duke punuar për të fituar besim më të madh, dhe bashkëpunim më të mirë, ndërmjet policisë dhe publikut, duke iu ofruar kurse trajnimi të specializuara për përkujdesje ndaj komunitetit. Kjo kërkon nga zyrtarët e policisë të krijojnë marrëdhënie më të afërta me komunitetet, kryetarët e fshatrave dhe zyrtarët vendor, dhe në të njëjtën kohë, të punojnë me ta në zgjidhjen e shqetësimeve të tyre rreth çështjes së sigurisë.

Roli i policit në komunitet

Në Kosovë, më shumë se 130 policë të SHPK-së janë caktuar të përkujdesen për komunitetin. Duke u marr me çështjet si vjedhjet nëpër shitore, siguria e fëmijëve në rrugë, parandalimi i abuzimit të drogës dhe marrëdhëniet ndëretnike, këta zyrtarë duhet të jenë të aftë të komunikojnë në mënyrë të duhur me njerëz të moshave të ndryshme, etnicitete dhe prejardhje të ndryshme. Po ashtu, nga ata kërkohet t'i organizojnë takimet në nivel lokal.

"Ne kemi kontakte me mësimdhënësit në shkolla, të rinjtë, pakicat, afaristët, përfaqësuesit komunal dhe me njerëz me nevoja të posaçme," thotë zyrtari i policisë Avni Zahiti, i cili punon në Shtabin Rajonal të Policisë në Mitrovicë. "Puna jonë është që t'i sjellim të gjithë në një tavolinë dhe t'i ndihmojmë rreth identifikimit të çështjeve të sigurisë dhe gjetjes së zgjidhjeve."

Zhvillimi i shkathtësive të reja

Qënga viti 1999, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka ndihmuar në zhvillimin demokratik të shërbimit policor. Në vitin 2000, kadetët e rinj filluan të njihen me konceptin e përkujdesjes ndaj komunitetit përmes programeve themelore për aftësimin e SHPK-së.

Ndonëse, kjo njohuri nuk ishte e mjaftueshme. "Policëve u mungonin disa shkathtësi të posaçme për kryerjen e detyrës në mënyrë të duhur," thotë togeri Salih Dragidella, Komandant i njesisë koordinuese për përkujdesje ndaj komunitetit në Prishtinë.

Kështu që, në shtator të vitit 2005, SHPK-ja dhe Misioni i OSBE-së, filluan ta zhvillojnë një kurs trajnimi të avancuar për t'i ndihmuar zyrtarët, që të punojnë në mënyrë më efektive me komunitetet.

"Kursi i ri shpjegon filozofinë e përkujdesjes ndaj komunitetit dhe synon zhvillimin e shkathtësive për komunikim, zgjidhje të problemeve dhe planifikim," thotë Sergey Sidorov, Instruktor për çështje policore në komunitet, që punon në Akademinë Policore të drejtuar nga OSBE-ja. Me vijimin e këtij trajnimi 40 orësh, vëmendje e posaçme i kushtohet edhe punës me fëmijë dhe të rinj.

"Për policinë është me rëndësi që të krijoj marrëdhënie të mira me pjesëtarët e komunitetit vendor, derisa ata janë të rinj," shton Sidorov. "Në këtë

mënyrë, mund t'i ndihmojmë ata, që t'i shmangen ndikimeve negative dhe të mos jepen pas krimeve."

Zahiti, njëri prej 19 zyrtarëve, i cili e ka kryer kursin në mars, të vitit 2006, thotë se zbatimi i konceptit të përkujdesjes ndaj komunitetit ishte i vështirë në fillim, por SHPK-ja është duke u përmirësuar në këtë drejtim. "Me kryerjen e këtij trajnimi, ndjehem më i përgatitur për të punuar me grupe të ndryshme të interesit."

Vënia e teorisë në praktikë

Gjatë ndekjes së kursit, pjesëmarrësit janë inkurajuar ta zgjedhin dhe zhvillojnë moton "Respektoni njerëzit dhe ata do të ju respektojnë!", mënyrë kjo për të demonstruar të kuptuarit e mirëfilltë, se çfarë përkujdesje policore i nevojitet komunitetit.

Njëra prej pjesëve më të rëndësishme të kursit është luajtja e roleve. Kjo inkurajon zyrtarët, që të kenë parasysh pikëpamjet e të gjitha palëve të ndikuara nga problemet, dhe si rezultat, të gjejnë zgjidhje më të mira.

Zahiti pajtohet, që kursi ka qenë i dobishëm: "Na ka ndihmuar për testimin e teorisë së mësuar për përkujdesjen policore ndaj komunitetit dhe jetësimin e saj në praktikë."

Pjesëmarrësit, po ashtu kanë prezantuar projekte drejtuar çështjeve siç janë: integrimi i romëve, siguria në trafik dhe në

lumenj, si dhe mbrojtja nga qentë e rrugës. Projektet, të cilat janë prezantuar në ditën e fundit të kursit, janë shumë të dobishme për zyrtarët përkujdesës ndaj komunitetit dhe tani ato u shërbejnë atyre.

Një pasqyrë më e plotë

Që nga koha kur OSBE-ja themeloi Akademinë Policore, në shtator të vitit 1999, kjo akademi ka ofruar kurse të një spektri të gjerë lëmenjsh, duke përfshirë mjekësinë ligjore, teknikat e intervistimit, taktikat e mbrojtjes, ndërhyrjet në konflikte, trajtimi i refugjatëve dhe kodi i mirësjelljes për policë. Deri më tani, 7,573 policë kanë vijuar programet themelore të trajnimit për policë, dhe 61,458 policë kanë ndjekur kurse specializimi nga më të ndryshmet, duke filluar nga hetimit e rasteve penale dhe mjekësia ligjore deri te kontrolli i trazirave dhe teknikave negociuese.

Grupit të kurseve të specializuara, i është shtuar edhe kursi i avancuar për përkujdesje ndaj komunitetit. Me kalimin e kohës, të gjithë zyrtarët e tanishëm dhe të ardhshëm, të caktuar për këto detyra do të duhet t'i vijojnë këto kurse.



Rishikimi i sektorit të sigurisë së brendshme të Kosovës

Michael Page, këshilltar për siguri të brendshme, Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme

Një prej aspekteve inovative të Rishikimit të Sektorit të Sigurisë së Brendshme të Kosovës (RSSB-së) është përpjekja, që në mënyrë sistematike të arrihet tek komunitetet në terren, sa më shumë që të jetë e mundur. Kjo ka involvuar një numër të metodave të ndryshme, përfshirë këtu konsultimet komunale, sondazhet, linjat e drejtpërdrejta telefonike, qasje në internet dhe "autobusin e RSSB-së", që siguron mekanizmin mobil për intervistim, dhe e dyfishon atë si reklamë/njoftim. Që nga fillimi, procesi i RSSB-së, ka qenë një iniciativë e ndërsjellë ndërmjet shoqërisë civile, IPVQ-ve dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Ndonëse, rishikimet e sektorit të sigurisë bëhen në mbarë botën, ato të shumtën e herëve janë të kufizuara në fushën apo metodologjitë përkatëse. Për shembull, në Irlandën veriore, një komision ndërkombëtar i kryesuar nga një ish politikan britanik dhe komisionar i ardhshëm evropian, Christopher Patten, i është drejtuar vetëm çështjes së policisë. Në anën tjetër, në Xhamajkë dhe Sierra Leone, janë kryer rishikime akoma më gjithëpërfshirëse të sigurisë, por nuk kanë qenë aq efektive për t'u realizuar me gjithë popullatën.

Kur është përgatitur projekti i RSSB-së për Kosovën, nga ekipi këshillimor për zhvillimin e sektorit të sigurisë të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, është marrë vendim, që të bazohen në mësimet e mësuara nga këto procese. Prosesi i RSSB-së ngërthen në vete dy pjesë vitale. Pikësepari, përmes krijimit të ekipit të kombinuar,

prej ekspertëve kosovarë dhe ndërkombëtar, sigurohet që njohuritë e njerëzve vendor do të mund kombinohen me ato të ekspertëve ndërkombëtar në kuadër të Sekretariatit të RSSB-së. Veç kësaj, përderisa sekretariati, institucionalisht është pjesë e UNDP-së, dhe gjendet në kuadër të zyrës së Kryeministrit për siguri publike. Në mënyrë të ngjashme, në hulumtim është involvuar një nivel i posaçëm i ndërveprimit ndërmjet agjencive, me pjesëmarrje të IPVQ-ve, UNMIK-ut, OSBE-së, UNDP-së, KFOR-it dhe dy organizatave të shoqërisë civile: Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF-it) dhe Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED-it).

Procesi i RSSB-së ndahet në tetë faza të veçanta: dy fazat e para, të cilat tanimë janë përfunduar, kanë identifikuar kërcënimet e brendshme dhe të jashtme, dhe mjedisin strategjik të Kosovës. Këto dy faza janë realizuar nga DCAF-i dhe KIPRED-i, të cilat kanë konstatuar kërcënimet primare, me të cilat përballet Kosova nga pikëpamjet bazë në tërësi. Ata theksuan, që siguria nuk do të thotë vetëm meshkujt në uniformë dhe me fishekë- por kjo është çështje shumë më komplekse. Një shoqëri, si kjo e Kosovës, e cila përballet me probleme të vështira ekonomike, dhe pasiguria në punë, që është një ndër çështjet më problematike, që një person mesatar mund të përballet. Kjo pasiguri krijon një mjedis, ku mund të zhvillohen krimi dhe ekstremizmi politikë, për një kohë të gjatë. Gjithashtu, meqë janë prezente

forcat ndërkombëtare të sigurisë, KFOR-i dhe NATO-ja, për momentin, gjasat janë jashtëzakonisht të vogla për ndonjë kërcënim nga jashtë, krahasuar me një numër vendesh pas konfliktit. Kështu që, do të ishte e pamundur për RSSB-në të aplikoj analiza "të gatshme" normale të sigurisë. Puna e përbashkët e DCAF-it dhe KIPRED-it ka siguruar një drejtim bazë për zhvillimin e mëtutjeshëm të RSSB-së.

Në fazat 3, 4, dhe 5, ekipi i RSSB-së i ka kryer vlerësimet, në pjesët e ndryshme të strukturës përgjegjëse për çështjet e sigurisë së Kosovës (SHPK-në, TMK-në, shërbimi civil etj) duke i përgatitur për zbrazësitë e analizave, që do t'i identifikonin nevojat dhe prioritetet, me të cilat do të mund të përballej qeveria e Kosovës, në periodën pas zgjedhjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Në nivel ndërkombëtar, ekipi i RSSB-së është duke i shfrytëzuar standardet e NATO-s dhe kriteret e Kopenhagës për integritet në BE, standarde këto sipas rekomandimeve të tyre. Megjithatë, standardi më i rëndësishëm për punën e ekipit është pikëpamja e popullit të Kosovës.

Procesi në terren dhe konsultimet janë në vazhdim e sipër, dhe veç kësaj pasqyron përkushtimet e shumë agjencive të ndryshme dhe organeve të Kosovës. Përmes ekipeve të veta në komuna, OSBE-ja ka zhvilluar diskutime rreth RSSB-së në secilën komunë në Kosovë. Cikli i parë i këtyre takimeve, të mbajtura në muajt shkurt dhe mars të këtij viti, ishin

pjesë thelbësore e punës, në ngritjen e vetëdijes së publikut për procesin e RSSB-së si dhe sigurimi i pikëpamjeve, aspiratave dhe drujtjeve prezente nëpër Kosovë. Tanimë, ka filluar cikli i dytë i konsultimeve të organizuara nga OSBE-ja, dhe do të vazhdoj gjatë muajve të verës.

Së bashku me këtë, dhe në bashkëpunim me departamentet për informim publik të UNMIK-ut dhe OSBE-së, ekipi i RSSB-së ka organizuar një fushatë të gjerë publike në terren. Një autobus i RSSB-së është në turne nëpër Kosovë duke incizuar, filmuar dhe regjistruar të dhënat me shkrim, për pikëpamjet e popullatës në përgjithësi. Ka pasur po ashtu, edhe një sërë debatesh në radio dhe televizion, që kanë shtjelluar çështjet lidhur me sigurinë, në mënyrë që të informohet popullata mbi çështjet, të cilat është duke u marrë ekipi i RSSB-së. Po ashtu, ka qenë një fushatë e vazhdueshme njoftimi, duke e paraqitur një slogan 'thuaj mendimin tënd për sigurinë' nëpër tërë Kosovën. Në fushatë janë përfshirë që të dyja, stendat e afishimit dhe reklamata televizive, dhe me këtë është menduar të inkurajohen njerëzit për pjesëmarrje në takime, shfrytëzim falas të linjave të drejtpërdrejta, faqet e internetit si dhe autobusi, në mënyrë që të sigurohen të dhëna për RSSB-në. Të gjitha informacionet e shfrytëzuara do të përfshihen në Raportin përfundimtar të RSSB-së, i cili do t'i dorëzohet qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës kah fundi i vitit 2006.

Ditari i Shërbimit Policor të Kosovës

Që nga themelimi i tij, Shërbimi Policor i Kosovës është ballafaquar me sfidat të mëdha qoftë në rrafshin e brendshëm, si zhvillimi i organizativ dhe krijimi i bazës ligjore për veprim, ashtu edhe në planin e jashtëm, si luftimin e krimit. Rritja e numrit të oficerëve të Shërbimit Policor të Kosovës krijon parakushte për një ambient më të sigurt për qytetarët e Kosovës. Për

më tepër, Shërbimi Policor i Kosovës konsiderohet të jetë një shembull i suksesit të bashkëpunimit mes institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Në mënyrë që të pasqyrohet një javë punë në Shërbimin Policor të Kosovës, në vijim janë paraqitur ekstrakte nga raportet e stacioneve të ndryshme policore gjatë javës së 21-27 maj 2006.



21 Maj 2006

Rreth orës 01:53 ankuesi S.K. ka raportuar tek Shërbimi Policor i Kosovës në Kamenicë se persona të panjohur i kanë vjedhur bagëtinë. I njëjti kishte shtënë një fishek me armë të gjuetisë. Patrulla e policisë kanë arritur të gjejnë bagëtinë e vjedhur, ndërsa të dyshuarit kanë ikur. Rasti i dedikohet Njesisë së Hetimit të Krimeve.

Shërbimi Policor i Kosovës në Pejë raporton për një vjedhje ku persona të panjohur nga vetura e N.A. kanë vjedhur një celular, kuletën së bashku me dokumentet personale dhe tetë kartela të bankave.

22 maj 2006

Me 21 maj 2006, dëshmitari A.G. derisa ishte duke prerë drunë për nevoja personale në një zabel në vendin e quajtur 'Lugat e Ozdrimit', afër lumit Drini i Bardhë në Komunën e Pejës, has në një kafkë të njeriut. Kjo kafkë supozohet se është nga lufta e zhvilluar në Kosovë në vitin 1998-1999. Për sigurimin e vendit të ngjarjes ka dal patrulla e nënstacionit policor të Vitomiricës. Gjithashtu, në vendin e ngjarjes ka dal edhe njësit i hetimeve regjionale. Rasti i dedikohet njësitit të hetimeve regjionale dhe njësitit për persona të zhdukur në Prishtinë.

Shërbimi Policor i Kosovës në Ferizaj njofton se rreth orës 01:05 në fshatin Prelez i Jerlive të Komunës së Ferizajt, dy persona të gjinisë femërore kanë kërkuar ndihmë në firmën "Univerzal" nga i dëm-

tuari D.S., gjoja se nuk po ju ndizet vetura. Pastaj, njëra nga sulmueset ka ndezur veturën dhe viktimën e kanë bartur zvarrë për afër 50 metra, gjë që i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore. Në rast kanë qenë të përfshirë edhe dy vetura, por targat nuk kanë mund të sigurohen. Rasti është nën hetime.

Rreth orës 11:00 në stacionin policor në Lipjan, ankuesi T.Sh. paraqet rastin e humbjes së pasaportës së UNMIK-ut. Sipas ankuesit pasaporta i ka humbur me 21 maj 2006 në Lipjan.

23 maj 2006

Shërbimi Policor i Kosovës në Rahovec pas një kontrolli rutinor konfiskon një pistoletë të tipit CZVZOR 50.

Rreth orës 15:00 në rrugën "Bajram dhe Gursel Sulejmani" në Ferizaj, nga ana e njësitit të hetimeve të narkotikëve është bastisur personi i dyshuar B.S., me ç'rast në xhepat e tij janë gjetur 14 pako me peshë 8 gramë me substancë të dyshuar narkotike (heroinë) të mbështjella me letër. Substanca është konfiskuar dhe i dyshuari është dërguar në paraburgim në Gjilan.

Gjatë patrullimit të njësisë së Shërbimit Policor të Kosovës në Pejë, patrulla e policisë ndalon furgonin Mercedes Benz 208 D-Kb, të cilin e drejtonte i dyshuari E.B. Në furgon kishte të ngarkuar pjesë për traktor, për të cilat nuk posedonte leje për transportin e tyre. Furgoni me mall është konfiskuar nga policia për çka është lëshuar edhe dokumenti mbi

konfiskim. Rasti i dedikohet Njësitit të Hetimeve.

24 maj 2006

Rreth orës 17:37 në Alfa Bazë të Shërbimit Policor të Kosovës në Pejë është pranuar një telefonatë nga ankuesi Sh.A. i cili njofton se në fshatin Jablanicë e Leshanit të Komunës së Pejës është thyer punëtorja e zdrukthëtarisë “Vëllezërit Ahmetaj” nga e cila janë vjedhur vegla të ndryshme makinerie. Policia del në vend të ngjarjes dhe mëson se gjatë orëve të mbrëmjes ndërmjet datës 23 dhe 24 maj 2006 person(a) të panjohur kishin depërtuar nëpërmjet çatisë së punëtorisë në fjalë dhe nga brenda kishin vjedhur makineri të ndryshme për përpunimin e drurit, të gjitha në vlerë sipas ankuesit rreth 10 mijë eurosh. Rasti i dedikohet Njësitit të Hetimeve.

25 maj 2006

Rreth orës 21:40 Shërbimi Policor i Kosovës në Lipjan merr një informatë se në lagjen Mostia të Lipjanit ka ndodhur një rast i dhunës familjare. Patrulla e cila ka arritur në vendin e ngjarjes ka konfirmuar se i dyshuari E.B. kishte keqtrajtuar bashkëshorten F.K. pas një grindjeje e cila dyshohet të ketë ndodhur rreth orës 10:30. I dyshuari më pastaj kishte dërguar viktimën te prindërit e saj me pretekst që të ndahet nga ajo. Policia në vend të ngjarjes ka kontaktuar nënën e të dyshuarit M.B., e cila kishte fillua të rrëfej për ngjarjen, por vërtetohet se njëjta ka qenë e përfshirë në rastin me F.K. të cilën e kishte sulmuar fizikisht. Rasti i dedikohet hetuesisë.

26 maj 2006

Rreth orës 17:00 në ëmbëlto-

ren “Orange” në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj Shërbim Policor i Kosovës njoftohet rreth dyshimit se gjatë pagesës është përdorur një monedhë fals prej 20 eurosh. Sipas disa dëshmitarëve i dyshuari është F.V., i cili këtë vepër e ka përsëritur ditë më parë. Rasti është nën hetime.

27 maj 2006

Rreth orës 09:45 në fshatin Lloshkobare të Komunës së Ferizajt duke mihur dheun është vërejtur një mjet i dyshuar i pashpërthyer. Pas njoftimit të KFOR-it, patrulla e Shërbimit Policor të Kosovës ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka bërë sigurimin e saj. Nga ana e njësitit të KFOR-it është konstatuar se mjeti është një projekt il artillerie me dimension rreth 70 centimetra

dhe 180 milimetra. Projekt il i dyshohet të jetë nga Lufta e Dytë Botërore. KFOR-i ka bërë tërheqjen e projekt ilit.

Rreth orës 10:42 njësitë e KFOR-it njoftojnë Shërbimin Policor të Kosovës në Mitrovicë se në rrugën “Drenica”, gjatë bastisjes së shtëpisë së Sh.M. është gjetur një pushkë “Bolt A.Rifle” me numër serik 183225 dhe 45 fishekë të kalibrit 8.57 mm. Arma është konfiskuar pasi që leje i kishte skaduar. Rasti është kompletuar dhe është dërguar në gjykatë.

Rreth orës 10:50 ankuesi S.L. nga fshati Gushtericë e Ulët të Komunës së Lipjanit raportoi Shërbimin Policor të Kosovës se gjatë natës persona të panjohur kanë vjedhur veturën Golf 1,9 E, ngjyrë hiri metalike. Sipas ankuesit vetura ka qenë e parkuar në oborrin e shtëpisë.



Kush do ta mbikëqyrë policinë?

Roli i Inspektoratit të Kosovës (IPK)

Përgjegjësia policore është komponentë jetike e secilës qeveri demokratike. Publiku ka nevojë të ketë besim në sistemin e qeverisë për 'mbikëqyrjen e policisë'. Qeveria duhet të jetë në gjendje të vëzhgojë për së afërmi çfarë është duke bërë policia dhe si është duke e bërë atë. Vetëm në këtë mënyrë, publiku mund t'i besojë policisë në mbështetjen e ligjit, ruajtjes së qetësisë dhe rendit dhe të siguroj se të gjithë qytetarët janë në gjendje të jetojnë dhe të punojnë në një mjedis të sigurt dhe të qetë.

Frank Harris, Menaxher projekti i programit të OSBE-s për zbatimin e IPK-së

Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) është organizata më e re policore e Ballkanit Perëndimor, ndërkaq që në shumë aspekte është edhe njëra prej modeleve më të mira të shërbimit demokratik policor në rajon. Ndonëse aktualisht gëzon mbështetjen dhe besimin e publikut, ShPK-ja është një organizatë që është në evoluim dhe zhvillim e sipër. Deri para pak kohësh, ShPK-ja nuk ka pasur mekanizëm të gatshëm formal për të siguruar përgjegjësi ndaj publikut. Megjithatë, tani, është formuar një organ civil mbikëqyrës dhe i pavarur: Inspektorati Policor i Kosovës (IPK). IPK-ja është "institutcion

ekzekutiv" në kuadër të Ministrisë së porsaformuar të Punëve të Brendshme të IPVQ-ve dhe është i definuar në Rregulloren e UNMIK-ut me Nr. 2005/54. IPK-ja do të përpiqet ta ndihmojë zhvillimin e mëtejshëm të ShPK-së me anë të formalizmit të përgjegjësisë ndaj publikut.

IPK do të ketë dy funksione primare. Së pari, do ta inspektojë performancën e ShPK-së dhe atë të një vargu funksionesh të menaxhimit për nga aspekti i efikasitetit dhe përputhshmërisë me ligjet në fuqi. Së dyti, IPK-ja do t'i shqyrtojë ankesat dhe akuzat për shpërdorimin e rëndë të pozitës ndaj policëve të ShPK-

së, pa marrë parasysh çfarë grade janë.

Përmirësimi i performancës së ShPK-së

Si do ta ndihmojë IPK-ja ShPK-në dhe si do ta motivojë ajo besimin e publikut më të gjerë ndaj ShPK-së? Do të ndërmerr hetime dhe do të përgatisë raporte për performancën e ShPK-së në lidhje me tre fushat thelbësore: efektshmërinë, kompetencën dhe përputhshmërinë me ligjin. IPK-ja do ta vëzhgojë me kujdes efektshmërinë e ShPK-së duke shqyrtuar se në çmasë është duke e përmbushur mandatin e vet ShPK-ja në luftë

kundër krimit, në ruajtjen e rendit publik dhe pakësimin e lëndimeve dhe vdekjeve në rrugë, si edhe fushat tjera. Po ashtu, IPK-ja do ta shqyrtojë efektshmërinë e ShPK-së duke gjurmuar mënyrën si policia është duke i shfrytëzuar fondet dhe nëse ajo është duke i arritur objektivat e veta në mënyrën më ekonomike të mundshme. Së fundi, IPK-ja do ta shqyrtojë përputhshmërinë e ShPK-së me ligjin duke analizuar si policët e ShPK-së janë duke e bërë punën e tyre dhe nëse janë duke i respektuar tërësisht rregullat gjatë kryerjes së asaj pune.

Si do ta masë Inspektorati i Policisë performancën e ShPK-së? Inspektorati do t'i zbatojë standardet evropiane të çështjeve policore - të definuara në Kodin Evropian të Etikës Policore-për matjen e performancës së udhëheqësve të ShPK-së. Kjo qasje është në përputhje me ambicien e qeverisë për të punuar drejt standardeve evropiane në të gjitha aspektet e administrimit.

Të gjitha shqyrtimet vjetor të IPK-së do të përmbledhen në një Raport Vjetor të Performancës së ShPK-së. I paraparë të jetë dokument publik, Raporti vjetor do t'i prezantohet PSSP-së, ministrit të punëve të brendshme dhe komisionarit të policisë. Raporti do të përmbajë informata faktike rreth performancës së ShPK-së,



Ceremonia e dorëzimit të kompetencave SHPK-së nga UNMIK-u

si edhe konkluzione objektive dhe rekomandime reale për ndryshime në të ardhmen. Çka është me rëndësishme, ky dokument do të paraqesë një vlerësim të performancës së ShPK-së, duke i theksuar pikat e forta dhe arritjet, si edhe pikat e dobëta që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm

Sistemi i ankimi të cilit publiku i beson

Funksioni i dytë i IPK-së, shqyrtimi i ankesave kundër policisë - është po aq i rëndësishëm, posaçërisht për pjesëtarët e rëndomtë të publikut. Kur ndonjë polic dështon së kryeri punën e tij ose kur e shkel ligjin, duhet të ekzistojë një sistem i efektshëm që ta bëjë atë të përgjegjshëm ndaj publikut, posaçërisht ndaj asaj pjese që vuan si pasojë e moskryerjes si duhet të punës nga ana e policisë. Sistemi i tillë kërkon një kornizë të fuqishme dhe të efektshme ligjore të punës, ashtu si edhe zyrtarë profesionalë për publik që janë të përgjegjshëm për shqyrtimin e ankesave dhe që e kanë besimin e publikut.

Rregullorja Nr. 2005/54 e UNMIK-ut dhe Direktiva Administrative përkatëse për IPK-në siguron një kornizë ligjore të fuqishme të punës për ankesat e publikut ndaj policisë. Fillimisht, të gjitha ankesat kundër policëve i dërgohen IPK-së, shqyrtohen aty, pastaj trajtohen sipas kategorisë së kundërvajtjes. Legjislacioni i ri i ndan akuzat potenciale të moskryerjes si duhet të detyrës nga ana e policisë në tre kategori: kundërvajtjet e vogla disiplinore, kundërvajtjet e rënda disiplinore dhe sjellja kriminale. Ashtu si në të kaluarën, cilado akuzë për sjellje kriminale do t'i referohet me-

njëherë prokurorit publik nga IPK-ja. Kundërvajtjet e vogla do t'i referohen Njesisë për Standardet Profesionale, nën autoritetin e komisionarit të ShPK-së, ndërsa akuzat për moskryerje të rënda të detyrës do të shqyrtohen nga zyrtarët e IPK-së. Në të gjitha rastet, IPK-ja do ta ndjekë zhvillimin e hetimeve për të siguruar se akuzuesi (ankuesi) është duke i mbajtur i informuar.

Nëse me anë të një hetimi të IPK-s zbulohet se ka dëshmi të forta që mbështesin një akuzë për moskryerje të rëndë të detyrës (keqadministrim) të rëndë, atëherë do të përgatitet një dosje dhe do t'i përcillet të Emëruarve të Lartë të Policisë dhe Komisionit Disiplinor (SPADC). SPADC-ja do t'i drejtojë seancat disiplinore dhe do të vendosë nëse policët janë fajtorë ose jo, dhe në rastet kur është e nevojshme, do t'ia rekomandojë PSSP-së ndëshkimet (në fund, ky autoritet do t'i transferohet IPVQ-ve të ministrit të punëve të brendshme). Gjatë drejtimit të një seance disiplinore SPADC-ja do të përbëhet nga një grup i vogël sekretarësh permanentë dhe përfaqësues të kuvendit të komunal, të përzgjedhur sipas radhës.

A mund publiku t'i besojë IPK-së? Të gjithë zyrtarët e IPK-së janë civilë dhe plotësisht të pavarur nga ShPK-ja. Ata do të punojnë shumë për të siguruar se secila ankesë për keqadministrim të rëndë po shqyrtohet tërësisht dhe në përputhje me ligjin në fuqi. Ashtu sikurse institucionet tjera qeveritare, IPK-ja do të gjykohet nga publiku për performancën e tyre dhe po aq do të mund të kritikohen nga publiku. Shpresohet që një mekanizëm civil i mbikëqyrjes do ta frymëzojë konfidencën

më të madhe të publikut sesa të lejohet që një divizion i vetëm i policisë ta investigojë divizionin tjetër.

Sfida e zhvillimit të IPK-së

Ashtu siç është cekur në Rregulloren Nr. 2005/54 të UNMIK-ut dhe në Udhëzimin Administrativ, zyrtari kryesor ekzekutiv i Inspektoratit të Policisë ka autoritetin ekzekutiv për funksionet e IPK-së dhe është përgjegjës ndaj Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pas një marrëveshjeje ndërmjet ambasadorit Enendt, UNMIK dhe ministrit të Punëve të Brendshme, OSBE-ja është pajtuar ta marrë përsipër udhëheqjen e projektit për zbatimin e IPK-së. Personeli i OSBE-së do të jetë përgjegjës për dizajnin dhe zbatimin si të ndërtimit të institucioneve ashtu edhe për fazat e ngritjes së kapaciteteve (kompetencës), ashtu si edhe monitorimin e performancës së IPK-së.

Përgatitja e zyrtarëve të IPK-së për funksionet e tyre të reja paraqet një sfidë të madhe. Funksionet e IPK-së janë të vetmet e këtij lloji në kuadër të institucioneve publike të Kosovës, kështu që ngritja e nevojshme e kapaciteteve është shumë e specializuar. Puna ka filluar me dizjanimin e programit dy fazor të ngritjes së kapaciteteve për personelin e IPK-së. Faza e parë e programit do të zgjasë 30 javë dhe do të fokusohet në mënyrën e drejtimit të inspektimeve revizionuese të menaxhimit të ShPK-së dhe si të përgatitet Raporti i parë Vjetor i performancës së ShPK-së. Përqendrimi i madh do të jetë në trajnimet e 'bazuara në punë'. Temat do ta përfshijnë inspektimin e policisë dhe shkathtësitë e

grumbullimit të të dhënave, aftësitë raportuese, aftësitë menaxhuese dhe udhëheqëse, njohuritë në lidhje me fushën e ligjeve në fuqi që kanë të bëjë me policinë, teori dhe praktikë të reformave policore dhe të ndryshimit organizativ.

Shpresohet se trajnimi i personelit të IPK-së do të fillojë në muajin qershor të vitit 2006. Një pjesë e madhe e materialit për trajnim tani është finalizuar dhe është në proces të përkthimit. Meqë IPK-ja duhet ta nxjerrë raportin e vet të parë të performancës së ShPK-së për vitin 2006, do të jetë e qenësishme të nxjerrë të dhëna dhe rekomandime që do të jenë rezultate të procesit të vazhdueshëm të trajnimit gjatë fazës e parë.

Faza e dytë e programit do të zgjasë 20 javë dhe do të fokusohet në shqyrtimin e ankesave për moskryerje si duhet të punës. Në këtë pjesë të programit të trajnimit do t'i jepet vëmendje intervistimit, grumbullimit të dëshmimeve, përgatitjes së dosjeve, paraqitjes së dëshmimeve dhe kuptimit të legjislacionit përkatës. Thënë edhe një herë, përqendrimi do të jetë në trajnimet e 'bazuara në punë', gjë që iu mundëson zyrtarëve të IPK-së ta marrin përgjegjësinë për shqyrtimin e ankesave sa më herët që është e mundshme.

Me qëllim që programi për ngritjen e kapaciteteve të niset sa më herët, OSBE-ja ka rënë në pajtim që të sigurojë një vend të përkohshëm trajnimi për personelin e IPK-së në bazën e OSBE-së logjistikës së (përballë rrugës për aeroport). Personeli i IPK-së do të

rivendoset në një vend të përhershëm sapo të përvetësohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Përvojat nga misioni i OSBE-s në Bosnjë dhe Hercegovinë gjatë zhvillimit të mbikëqyrjes parlamentare të sektorit për siguri të BH-së

Christian Haupt, Misioni i OSBE-s në Bosnjë dhe Hercegovinë

Mbikëqyrja parlamentare e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë në Bosnjë dhe Hercegovinë është një sfidë e vërtetë, megjithatë gjatë tre viteve të fundit ka pasur përmirësime të konsiderueshme. Duke filluar nga zeroja në vitin 1995, sot mbikëqyrja parlamentare në BH ka arritur të bëhet model për vendet tjera të Evropës Jugperëndimore. Sido që të jetë, mbikëqyrja parlamentare vazhdon së përmirësuari, me thellimin e njohurive të parlamentarëve dhe të këshilltarëve për çështje të ndryshme dhe për mënyrat e bashkëpunimit në adresimin e këtyre çështjeve.

Misioni i OSBE-s në BH ka një mandat të përmirësimit të stabilizimit rajonal (si edhe avancimin e të drejtave të njeriut dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve) nga "Korniza e marrëveshjes së përgjithshme në Bosnjë dhe Hercegovinë" (GFAP)¹, e nënshkruar me 14 dhjetor të vitit 1995, në Paris, pasi negociatën në Dayton, Ohio, SHBA, me 21 nëntor, 1995. Me qëllim të përmbushjes së këtij mandati, OSBE-ja e ka themeluar një Departament të Stabilizimit në Rajon (DSR), i cili tani quhet Departamenti i Bashkëpunimit për Çështjet e Sigurisë (DSC). Fillimisht, ky departament fokusohej në mbështetjen e zbatimit të ashtuquajturës Marrëveshja e Vjenës për siguri dhe masat e ndërtimit të Sigurisë dhe Marrëveshja

e Firences për kontrollin nënrajonat të armëve. Që nga atëherë, zbatimi i që të dyja marrëveshjeve është përmirësuar dukshëm, ndërsa bartja e plotë e kompetencave nga niveli aktual në nivel shtetëror është kompletuar me 1 janar të vitit 2006, Sektori i mbrojtjes në BH ka ndryshuar rrënjësisht me anë të bartjes së plotë të kompetencave.

Prej kur Marrëveshja e Vjenës përfundoi, ndërsa Marrëveshja e Firences u ndryshua, DSC-ja e ka zgjeruar gamën e vet fillestare të aktiviteteve. Tani, ajo ndihmon zbatimin e dimensionit politiko-ushtarak të dokumenteve të OSBE-s. Në kuadër të këtyre dokumenteve është Kodi i Veprimit i OSBE-s për aspektet politiko-ushtarake të sigurisë (Budapest, 1994), i cili përmban dispozita të qarta për mbikëqyrjen parlamentare të forcave ushtarake.

Korniza institucionale

Deri në vitin 2003, qeveria e nivelit shtetëror e BH-së ushtronte kontroll të pakët mbi sektorin e sigurisë, ndërsa që nuk kishte fare struktura të efektshme ushtarake dhe policore të nivelit shtetëror. Si pasojë e luftës paraprake, që të dyja entitetet në kuadër të BH-së² ruanin një nivel të lartë të pavarësisë institucionale, duke i përfshirë ministrinë e veta të mbrojtjes (përgjegjëse për forcat e armatosura) dhe ministrinë e mbrojtjes (përgjegjëse për forcat policore). Kushtetuta e BH-së krijoi një Komision të Përhershëm për çështjet ushtarake në kuadër të presidencës shtetërore të BH-së për koordinimin e forcave të armatosura përkatëse të entiteteve, megjithatë ky komision nuk luante rol vendimmarrjeje.

Po ashtu, deri në vitin 2003, mbikëqyrja parlamentare e forcave të armatosura të sigurisë (ushtria, policia, shërbimi sekret) ka qenë e kufizuar në parlamentet ekzistuese. Në mungesë të një ministrie shtetërore të mbrojtjes dhe ministrie të punëve të brendshme, elementet nacionaliste në kuvendin parlamentar të BH-së (KP i BH-së) ishin në gjendje të shfrytëzonin arsye ta parandalonin themelimin e një komisioni mbikëqyrës për çështjet e sigurisë, me këtë duke rezervuar më shumë fuqi për komisionet e mbikëqyrjes parlamentare të nivelit të entitetit. Një prej arsyeve ishte: nëse mekanizmat organizohen në nivel të entitetit, mekanizmat e mbikëqyrjes duhet të jenë të po atij niveli.

Megjithatë, në vitin 2003, BH-



¹ I tërë teksti i GFAP-it, përfshirë edhe shtojcat, është në faqen e internetit të Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë, adresa: www.ohr.int

² Dispozitat e GFAP-it, përfshirë edhe Kushtetutën e BH-së (Shtojca 4 e GFAP-it), ka krijuar dy nën entitete në kuadër të BH-së: Federatën e BH-së (FBIH) dhe Republika Srpska-në (RS).

ja pati një sukses të madh në krijimin e mbikëqyrjes shtetërore demokratike të strukturave të sigurisë. Në maj të po atij viti, Përfaqësuesi i Lartë, (i barabartë me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë) themeloi Komisionin e Reformave të Mbrojtjes (DRC) që ra dakord për formimin e një ministrie shtetërore të mbrojtjes në BH. Pasi DRC-ja publikoi një raport në shtator të vitit, Kuvendi Parlamentar i BH-së, themeloi Komisionin e Përbashkët për politikën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe për monitorimin e punës së mbrojtjes dhe strukturave të sigurisë në nivel të BH-së. Komisioni i Përbashkët me 12 anëtarë (6 nga secila dhomë e kuvendit parlamentar të BH-së) mbikëqyrë punën e Ministrisë së Mbrojtjes së BH-së dhe të Ministrisë së Sigurisë të BH-së, ku ky i fundit drejton një institucion shtetëror për shërbime kufitare dhe një tjetër sosh për hetime dhe mbrojtje. Gjithashtu, Komisioni i Përbashkët mbikëqyrë Zyrën Kombëtare të Interpolit dhe Qendrën e BH-së për veprim kundër minave. Me këtë fushë të gjerë të përgjegjësive, Komisioni i Përbashkët mbulon po thuhet tërë sektorin e sigurisë, përveç Agjencisë së BH-së për Shërbime Sekrete (OSA) që është subjekt i mbikëqyrjes së një komisioni tjetër të Kuvendit Parlamentar të BH-së.

Mbikëqyrja e sektorit të mbrojtjes tani i është transferuar tërësisht Komisionit të Përbashkët parlamentar të nivelit shtetëror të BH-së. Megjithatë, përkundër them elimit të Komisionit të Përbashkët, komisionet parlamentare të nivelit të entiteteve mbajnë kompetenca të dukshme në

mbikëqyrjen e sektorit policor si në FBiH ashtu edhe në RS.

Korniza legjislative për mbikëqyrjen parlamentare

Kuvendi Parlamentar i BH-së dhe ministrat e mbrojtjes të FBiH-së janë të obliguar me Ligjin e Mbrojtjes dhe me rregulloret e BH-së t'iu raportojnë rregullisht komisioneve të tyre përkatëse të përbashkëta për procesin e vazhdueshëm të tranzicionit, ose sipas kërkesës për çfarëdo çështje tjetër. Fuqitë e komisionit mbikëqyrës në Kuvendin Kombëtar të RS-së (RSNA) janë të definuara me anë të një Ligji të detajuar për Mbikëqyrje Parlamentare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (Gazeta zyrtare e RS-së, Nr. 25/2005). Fatkeqësisht, komisioni i RSNA-s i ka përdorur rrallë mjetet dhe autorizimet e fuqishme që i jepen me ligj. Kjo tregon se efektshmëria e komisioneve mbikëqyrëse varet si nga përkushtimi i parlamentarëve ashtu edhe nga dispozitat e qarta të ligjit.

Zhvillimi i Projektit të Misionit të OSBE-s për mbikëqyrjen parlamentare

Nisma e parë kryesore e OSBE-s në fushën e mbikëqyrjes demokratike, parlamentare të forcave të armatosura ka qenë organizimi i një seminari në janar të vitit 1999 me titullin: "Kontrolli demokratik i politikës së sigurisë dhe i forcave të armatosura". Në vitin 2000, DRS-ja e OSBE-s (tani DSC, shih më lartë) ka futur në veprim një program afatgjatë të mbështetjes për mbikëqyrjen parlamentare të forcave të armatosura. Në fazën fillestare, DRS-ja thjesht përpikëq ta kultivonte besi-

min e ndërsjellë ndërmjet përfaqësuesve të lartë në sektorin e mbrojtjes. Njëra prej iniciativave të para të saja në këtë fushë ishte organizimi i tre takimeve formale me kryesuesin e komisioneve të mbrojtjes dhe të sigurisë të nivelit të entiteteve të parlamentit.

DRS-ja është përfshirë në mënyrë aktive me organizatat tjera bashkëpunuese dhe personelin tjetër për ngritjen e kapaciteteve në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Duke e njohur rëndësinë e mbështetjes teknike dhe administrative, DRS-ja i ka inkurajuar sekretariatet e komisionit të marrin pjesë në aktivitetet, dhe ata kanë dhënë kontribute të dukshme në mënyrë që projekti të jetë i suksesshëm. Po ashtu, për t'i plotësuar aktivitetet e DRS-së, Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) iu është bashkëngjitur misionit të OSBE-së në drejtimin e një pilot-projekti për sigurimin e ekspertëve vendorë në mbrojtjen parlamentare dhe komisionet e sigurisë. Që nga viti 2003, janë angazhuar ekspertë nga DCAF-i për të punuar për katër komisionet ekzistuese të mbrojtjes dhe sigurisë. Këta këshilltarë sigurojnë ekspertizën e nevojshme për çështjet e sigurisë, ndërkaq që në masë të madhe e kanë përmirësuar aftësinë e parlamentarëve që të marrin pjesë në mënyrë të suksesshme në negociatat për reformat e mbrojtjes.

Përvorjat dhe sfidat

Përfaqësuesit vendorë dhe ndërkombëtarë mbikëqyrjen parlamentare të DSC-së (dhe DRS-ja para saj), e kanë përshkruar shpesh si një nga

aspektet më të suksesshme të reformave të sektorit të sigurisë së BH-së, posaçërisht në reformat e mbrojtjes. Mbikëqyrja e rritur, jo vetëm që ka qenë në gjendje t'i mbajë të përgjegjshme strukturat ekzekutive, por, ka kontribuar edhe në zbatimin e legjislacionit të miratuar nga Kuvendi Parlamentar i BH-së.

Duke shikuar drejt së ardhmes, ka shqetësime në lidhje me rëndësinë e ruajtjes së personelit adekuat dhe pajisjeve të nevojshme teknike për pjesëmarrjen efikase të parlamentarëve në këto komisione. Pa këto burime, parlamentarët nuk do të jenë në gjendje të ushtrorjnë mbikëqyrje efikase, posaçërisht gjatë përbashkësimit me paqartësinë e institucioneve të BH-së për siguri dhe mbrojtje.

Ndoshta, mësimi më i rëndësishëm i mësuar gjatë shtatë viteve të fundit është vlera e lartë e interesimit dhe e përkushtimit të parlamentarëve për çështjet. Pa këto veçori, mbikëqyrja parlamentare nuk do të ishte e efektshme. Ngjashëm, marrëdhëniet që përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar i kultivojnë me parlamentarët janë po aq të rëndësishme. Këshillat profesionale për, dhe mbështetja e përditshme e komisioneve duhet të sigurohen në mënyrë të respektueshme. Atmosfera e partneritetit dhe e kuptimit të ndërsjellë mund të zhvillohet vetëm me anë të një kombinimi të përpjekjeve të respektueshme, thellësisht të zotuar dhe të ndërsjella. Bashkëpunimi i tillë është i qenësishëm për zhvillimin e mbikëqyrjes së efektshme parlamentare në vendet e Evropës Jugperëndimore.

Programi i këshilltarëve të stafit parlamentar për komisionet e mbikëqyrjes

Marc Remillard, menaxher i programit, Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura (DCAF)



E themeluar në tetor të vitit 2000, Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) e përkrahë qeverisjen e mirë dhe reformimin e sektorit të sigurisë në vendet e Evropës Juglindore. Qendra në fjalë zhvillon hulumtime të ushtrimit të mirë detyrës, inkurajon zhvillimin e normave të duhura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, rekomandon politika dhe siguron këshillime dhe programe ndihmëse në vend. Partnerët e DCAF-it i përfshijnë qeveritë, parlamentet, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe një spektër veprimtarësh të sektorit të sigurisë, siç janë: policia, agjencitë policore, juridike, të shërbimit sekret, shërbimet e sigurisë kufitare dhe të atyre ushtarake.

Shkurt, pasi DCAF-i filloi operacionet, ubëe qartëse poqë se do të ofronim mbështetje të plotë, të orientuar në rezultate, atëherë nuk do të mjaftonte të fokusoheshim vetëm në mbështetjen e parlamentarëve. Në mjediset tranzicionale, parlamentarët shpesh vijnë dhe shkojnë me një vazhdë të shpejtë, përderisa personeli profesional parlamentar mbetet dhe bëhet burim i brendshëm thelbësor në dis-

pozicion të parlamentarëve, disa prej të cilëve mund t'iu mungojë dukshëm përvoja parlamentare. Sido që të jetë, kemi zbuluar se sekretariateve parlamentare shpesh u mungon trajnimi, burimet dhe qasja në dokumentet sensitive të nevojshme për punën rreth çështjeve të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes. Në fakt, informatat për këto çështje janë të kufizuara për këdo jashtë ministrisë së mbrojtjes dhe këshillave të qeverisë për siguri, kështu që, madje edhe parlamentarët mund të kenë ndikim të kufizuar në këto fusha. DCAF-i ka zbuluar se në shtetet një partiake, parlamentet shpesh vetëm e miratojnë në mënyrë të gatshme legjislacionin që ka të bëjë me sigurinë dhe mbrojtjen.

Njohja e këtyre sfidave ka shpjerë drejt zhvillimit të njërit nga programet më afatgjatë dhe më të suksesshme të DCAF-it, Programi i Këshilltarëve të Stafit Parlamentar (PSAP), që financon dhe trajnon këshilltarët e stafit në kuadër të sekretariateve parlamentare. Këshilltarët punojnë si ekspertë të komisioneve – si staf i qenësishëm shtesë i sekretariatit-për mbrojtje, rend publik ose për komisionet e mbikëqyrjes së shërbimit të sekret. Programi ofron vetëm këshilltarë stafi për një komision në secilin parlament. Me këshilltarët e parlamenteve dhe të stafit, PSAP-në e kemi futur në veprim në fund të vitit 2002. Që nga atëherë, PSAP-ja është shndërruar në një program të vërtetë

mbarë rajonal që përfshin 11 këshilltarë të parlamenteve dhe 12 këshilltarë stafi. Që nga maji i vitit 2006, parlamentet e përfshira janë nga Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, IRJ e Maqedonisë, Rumania dhe Serbia e Mali i Zi, në raste të caktuara, duke i përfshirë edhe parlamentet e nivelit shtetëror, republikan dhe të entiteteve. Në bazë të një marrëveshjeje që është arritur në maj të vitit 2006, kemi kënaqësinë të theksojmë se Kuvendi i Kosovës, pritet t'i bashkëngjitet programit në fund të muajt qershor të vitit 2006. Sipas marrëveshjes, kërkohet që Kuvendi të punësojë 2 këshilltarë stafi vendorë të financuar nga DCAF-i për mbështetjen e drejtpërdrejtë të punës kryesore të Komisionit për Emergjencë dhe Gatishmëri – komision ky, përgjegjës të mbikëqyrëse të të cilit do t'i përfshijnë strukturat e brendshme të sigurisë në Kosovë. Secili nga këshilltarët e stafit do ta përfaqësojë njërin prej dy komuniteteve etnike më të mëdha në Kosovë.

Krahas ofrimit të financimit për këshilltarët e komisionit, DCAF-i, gjithashtu, ofron një program vjetor trajnimi për parlamentet pjesëmarrëse. Kemi bërë katër vizita një javore trajnimi për parlamentet tjera kombëtare. Në shumicën e rasteve, programet e trajnimit strukturohen në bashkëpunim të ngushtë me parlamentet tjera kombëtare, që ofrojnë seanca trajnimi dhe debate në vend, për temat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen dhe përgjegjësitë e sektorit të sigurisë. Deri më

sot, këshilltarët kanë vizituar parlamentet e Danimarkës, Rumanisë, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe të SHBA-ve, si edhe kuvendin parlamentar të NATO-s dhe një numër organizatash tjera. Në të gjitha rastet, pjesëmarrësit njoftohen me kujdes me rolin e parlamentit në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë, krahas njoftimit me një larmi të gjerë personalitetesh ndërkombëtare, që janë vendimtarë për punën e tyre të së ardhmes në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me standardet dhe programet Euro-Atlantike të integritimit.

Parullat e PSAP-së janë zotërimi dhe mbikëqyrja e efektshme. Edhe pse, viti i tretë dhe përfundimtar i financimit mund të shqyrtohet në rast të kufizimeve të jashtëzakonshme buxhetore, parlamentet pjesëmarrëse inkurajohen të marrin zotërimin e pozitave të stafit pas financimit dy vjeçar të DCAF-it. Megjithatë, përvoja tregon se para se të arrihet ky afat i caktuar, disa prej parlamenteve të përfshira i kanë institucionalizuar pozitat e këshilltarëve të stafit dhe si rezultat i kanë bërë ato pjesë të përhershme të komisionit përkatës të mbikëqyrjes. Me qëllim të vazhdimin të përmbyshjes së nevojës së qartë për trajnimin e më shumë këshilltarëve të stafit, dhe për kultivimin e rrjetit rajonal të zhvilluar në mesin e tyre, ne vazhdojmë të ofrojmë trajnime vjetore për këshilltarët e kombëtarizuar të stafit edhe pse ata nuk financohen më nga DCAF-i

Konferenca parlamentare rajonale për mbikëqyrjen e sigurisë

25-27 qershor 2006-Mitrovicë

„Drejt zhvillimit të një mbikëqyrjeje efikase parlamentare të sigurisë“



Me 25-27 qershor , ne Mitrovicë u mbajt Konferenca parlamentare rajonale për zhvillimin e një mbikëqyrjeje efikase parlamentare te sigurisë. Ne këtë ngjarje te organizuar se bashku me DCAF-in, OSBE-ne dhe Kuvendin e Kosovës, morën pjese rreth 40 parlamentar nga rajoni, me përvoja ne mbikëqyrjen parlamentare dhe sektorin e sigurisë. Një ndër konkludimet tjera te konferencës ishte zotimi për një bashkëpunim te ngushte ne nivel rajonal, veçanërisht lidhur me mbikëqyrjen e kompanive private te sigurisë



Recent Developments in the Assembly

Franklin De Vrieze, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Katër parlamente evropiane mbështesin Kuvendin e Kosovës

Me 22 maj, konzorciumi i përbërë nga katër parlamente të Evropës, dhe i financuar nga AER-i, ka filluar zyrtarisht programin e tij për mbështetjen e Kuvendit. Ky projekt do të zgjasë dy vite. Mbështetja e konzorciumit të katër parlamenteve evropiane (Francës, Gjermanisë, Belgjikës dhe Sllovenisë), do të përqendrohet kryesisht në procesin e ndërtimit të institucioneve, me qëllim të fuqizimit të punës së Sekretariatit të Kuvendit përmes trajnimeve dhe ndërtimit të kapaciteteve. Pos kësaj, konzorciumi do të sigurojë asistencë teknike për Departamentin për Çështje Ligjore jo vetëm për shqyrtimin e legjislacionit, por edhe për hartimin, standardizimin dhe harmonizimin e legjislacionit. Njëherësh, projekti do të fokusohet në funksionimin e komisioneve të Kuvendit dhe të Kryesisë së Kuvendit, dhe ndërveprimin me shoqërinë civile.



REPUBLIKA SLOVENIJA
DRŽAVNI ZBOR



Institut International
de Paris La Défense

Grupet parlamentare mbajnë konferenca për zhvillimin e politikave

Gjatë muajit qershor, çdo grup parlamentar do të organizoj nga një konferencë për zhvillimin e politikave, me temë sipas dëshirës së tyre, duke sjellur së bashku ekspertët e vendit dhe të jashtëm, në mënyrë që t'i zhvillojnë rekomandimet për politikën e grupeve të tyre parlamentare. Më 6 qershor, grupi parlamentar i AAK-së, ka organizuar konferencën e parë mbi politikën bujqësore, me fjalimet e mbajtura nga përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe nga një numër bujqish dhe bankierësh. Më 12 qershor, Grupi Parlamentar i PDK-së ka organizuar një konferencë për politikën mbi privatizimin dhe energjinë. Më 13 qershor, Grupi Parlamentar i LDK-së ka organizuar një diskutim drejtë mbi planin e veprimit të rinisë së Kosovës. Grupi Parlamentar ORA ka organizuar një konferencë njëditore mbi planin e veprimit të rinisë së Kosovës. Më vonë gjatë muajit qershor, SLKM do të organizoj një tryezë të rrumbullakët diskutimi mbi mbrojtjen institucionale të interesave të serbëve të Kosovës. Këto konferenca janë duke u përgatitur nga studentët-praktikantët të Universitetit të Prishtinës (apo Universitetit të Mitrovicës për SLKM) si pjesë e projektit të OSBE-së me grupet parlamentare në Kuvendin e Kosovës..

Reformimi i punës së Kuvendit

Me 1 qershor, Kuvendi ka vendosur ta përmirësojë funksionimin e vet, duke miratuar një paket gjithëpërfshirëse reformash të propozuara nga presidenti i Kuvendit, Z. Kolë Berisha.

Këto reforma kanë për qëllim mbështetjen e Kuvendit në mbikëqyrjen më efikase të punës së qeverisë nëpërmjet mekanizmave formalë të shqyrtimit parlamentar. Do të caktohet koha e rregullt për pyetje, ndërkaq që interpelancat për ministrat do të propozohen dhe do të debatohen më shpesh. Plani reformues, gjithashtu, parasheh një kalendar të takimeve fikse për pjesën e mbetur të vitit 2006, duke mundësuar në këtë mënyrë 2-3 seanca plenare në muaj dhe takime të rregullta të udhëheqësve të grupeve parlamentare dhe kryesuesve të komisionit.



Për herë të parë, Kuvendi i Kosovës do të përfshihet në mënyrë të shtrirë në përgatitjen e buxhetit të vet. Komisioni për Buxhetin e Kuvendit ka filluar një seri konsultimesh me kryesuesit e grupeve parlamentare dhe kryesuesit e komisioneve të veta për identifikimin e prioriteteve për buxhetin e vitit të ardhshëm të Kuvendit, duke i marrë në konsideratë shtrëngimet buxhetore. Së fundi, plani reformues i Kuvendit, po ashtu, parasheh një administrim më të efektshëm, duke e përmirësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare dhe duke formuluar një plan menaxhimi të Kuvendit dhe një program për vizitorët e Kuvendit.

Gjatë seancës plenare me 1 qershor, të gjitha grupet parlamentare mirëpritën reformat, duke shprehur mirënjohje ndaj Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) për asistencën e dhënë në hartimin e propozimit dhe ndaj OSBE-s për monitorimin e raporteve që kanë vënë në pah çështjet që duhet të adresohen.

Deputetët e Kuvendit përgatiten për t'i parashtruar pyetje Qeverisë

Me 7 qershor, Instituti Nacional Demokratik (NDI-ja), organizoni një seminar për deputetët e opozitës në Kuvend rreth përgatitjes së pyetjeve dhe interpelancave për Qeverinë. Me këtë rast, z. Ramë Manaj, këshilltarë i lartë i Kryetarit të Kuvendit, vuri në pah mundësitë për t'i shtruar pyetje Qeverisë duke u bazuar në "Planin e Standardeve të Kuvendit" të miratuar kohë më parë. Po kështu, gjatë seminarit, z. David Payne, ish deputet nga Kanada dhe z. Petra Blaess (OSBE), ish deputete nga Gjermania, shkëmbyen përvojat e tyre lidhur me parashtrimin e pyetjeve zyrtarëve të Qeverisë. Njëherësh, përmes video xhirimeve u shfaqën edhe fragmente nga koha për parashtrimin e pyetjeve në parlamentet e BM-së dhe Skocisë. Numri i përgjithshëm i deputetëve që morën pjesë në këtë seminar ishte 13: 7 deputetë të PDK-së, 2 të ORA-s dhe 2 nga Grupi për Integrim. Ndërkaq, këtë javë NDI-ja do të organizojë një seminar të ngjashëm për zyrtarët e ministrive për atë se si të përgjigjen në pyetje dhe interpelanca që u parashtrohen atyre.

Kuvendi debaton rreth raportit përfundimtar për BKK-ën e vitit 2005

Me 2 qershor, Kuvendi debatoi rreth raportit përfundimtar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK-së) për vitin 2005. Me këtë rast, prezantimet e përfundimeve kryesore të raportit i bënë Ministri i Ekonomisë dhe Financave, z. Haki Shatri, dhe pas tij, z. Naser Osmani, kryetar i Komisionit të Kuvendit për Buxhet dhe Financa. Ndërkaq, z. Jakup Krasniqi (PDK) e kritikoi qeverinë si për mungesë të transparencës dhe fshehjen e manipulimeve buxhetore ashtu edhe për shpenzime të tepërta, për fjala vjen fatura të telefonit, udhëtime zyrtare dhe blerje të makinave. Megjithatë, z. Alush Gashi (LDK) shprehu mbështetjen e grupit të tij parlamentar për raportin përfundimtar të BKK-së për vitin 2005. Kështu që, raporti u miratua me 52 vota për dhe 21 vota kundër. Po kështu, javëve të fundit Kuvendi i ka nisur konsultimet e brendshme lidhur me përgatitjet për buxhetin e vitit 2007.

Kuvendi i Kosovës merr pjesë në takimin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s

P prej 26 deri me 30 maj në Paris u mbajt sesioni pranveror i Asamblesë Parlamentare (AP) të NATO-s. Me propozimin e Misionit të OSBE-së në Kosovë kryetari i AP të NATO-s ftoi një delegacion të Kuvendit të Kosovës që të marrë pjesë në këtë ngjarje. Delegacioni përbëhej nga Dr. Alush Gashi (LDK), Dr. Hajredin Kuqi (PDK), z. Oliver Ivanoviq (SLKM) dhe një përfaqësues i OSBE-së. Vlen të vihet në dukje se kjo ishte hera e parë që deputetët e Kuvendit ishin ftuar të marrin pjesë në një sesion të rregullt të AP të NATO-s.

Në prag të mbajtjes së Samitit në Riga, që do të mbahet në nëntor të vitit 2006, në sesionin e AP të NATO-s u diskutua për çështje të ndryshme politike dhe të sigurisë, siç janë situata në Bjellorusi, Ukrainë, Iran, Irak, Afganistan, Gjeorgji, pastaj marrëdhëniet me Rusinë, etj. Ndërkaq, në kuadrin e përgatitjeve për samitin në Riga, me 30 maj Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap De Hoop-Scheffer së toku me të gjithë ambasadorët e Këshillit të Përhershëm të NATO-s iu bashkuan takimit të Asamblesë Parlamentare për të diskutuar lidhur me planet e ardhshme të NATO-s.

Një nga çështjet që u diskutua gjatë takimit të Komisionit për Politikë të AP të NATO-s ishte edhe procesi për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Me këtë rast, ambasadori Albert Rohan mbajti një fjalim gjithëpërfshirës, i cili u përqen-

drua në çështje të ndryshme si: rezultatet e pesë raundeve të bisedimeve në Vjenë, afatet kohore për konkludimin e bisedave për status deri në fund të vitit 2006, rasti i Kosovës- nuk përbën precedent, qasjet e Beogradit dhe Prishtinës në bisedime, dhe jetësimin e standardeve.

Ndërkaq, delegacioni i Kosovës propozoi që të organizohet mbajtja e njërit nga seminaret e radhës së AP të NATO-s Rose Roth në Prishtinë. Propozim ky i cili u mirëprit nga të gjithë zyrtarët e AP të NATO-s.





Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinatori i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Franklin De Vrieze, Skender Durmishi, Blerim Vela, Alfons Lentze, Ramë Manaj, Edmond Efendija, Krenar Loshi, Labinot Hoxha.

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :

OSBE-ja: 1, 2, 3, 4, 6, 8, 10, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 20, 22, 25, 26, 27
Express: Fisnik Dobreci: 1, 19, Astrit Ibrahim: 1, 18, Christophe Quirion: 11.